



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 393 Akti

Nr. 543 Vendimi
Tiranë, më 28.6.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Pamela Qirko	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datat 6 qershor 2022, ora 13:00; 14 qershor 2022, ora 13:00 dhe në datën 24 qershor 2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*) Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Altin Abdiu**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancat dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES / SEANCAT DËGJIMORE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Abdiu, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), më 16.12.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Abdiu, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 20.12.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit¹.
5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i

¹ Vendim i ndërmjetëm nr. ***, datë 20.12.2019.

Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin² e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- a. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b. nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e prindërve;
- c. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin³ e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dhe analizuar tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor që i përkasin periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si edhe të dhënat nga burimet arkivore, duke dërguar një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Abdiu.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 4.5.2022, vendosi⁵: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 4.5.2022, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 5.5.2022, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve

² Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë me nr. *** prot., datë 1.10.2018.

³ Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së me nr. ***, datë 20.1.2021.

⁴ Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 30.6.2021.

⁵ Vendim i ndërmjetëm nr. ***, datë 4.5.2022.

në datën 24.5.2022, në rrugë elektronike me e-mail dhe duke i depozituar fizikisht në Komision prapësimet e tij të shoqëruara me prova mbështetëse⁶.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion, trupi gjykues, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁷. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me e-mail, në datën 26.5.2022.

17. Seanca e parë dëgjimore u zhvillua më 6 qershor 2022, ora 13:00, gjatë së cilës trupi gjykues njoftoi⁸ subjektin e rivlerësimit, z. Altin Abdiu, cili ishte prezent në seancë, se është pranuar kërkesa⁹ e depozituar nga përfaqësuesja e tij ligjore, znj. A.S, për shtyrjen e seancës dëgjimore, duke i komunikuar se seanca e radhës do të zhvillohej në datën 14 qershor 2022, ora 13:00. Ky vendim iu komunikua edhe përfaqësuesit ligjor të subjektit, znj. A.S, me e-mailin e datës 6.6.2022.

18. Seanca e dytë dëgjimore u zhvillua në datën 14 qershor 2022, ora 13:00, gjatë të cilës subjekti i rivlerësimit depozitoi kërkesën për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, znj. Etleda Çiftja. Pasi verifikoi dhe vlerësoi këtë kërkesë, trupi gjykues vendosi¹⁰ ndërprerjen e seancës dëgjimore, me qëllim transferimin e kësaj kërkesë Mbledhjes së Komisionit për të ngritur me short një tjetër trup gjykues për shqyrtimin e saj.

19. Në datën 17.6.2022, trupi gjykues i ngritur për këtë qëllim¹¹, me shumicë votash vendosi¹² pranimin e kërkesës për përjashtimin e komisioneres Etleda Çiftja nga shqyrtimi i mëtejshëm i çështjes së subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu.

20. Në vijim, pas procedurës së shortit të zhvilluar, po në datën 17.6.2022, anëtar i trupit gjykues për shqyrtimin e kësaj çështjeje, u caktua komisionerja Suela Zhegu¹³. Nga anëtarja e trupit gjykues, znj. Suela Zhegu, si edhe nga subjekti i rivlerësimit, z. Altin Abdiu, u deklarua mospasja e e konfliktit të interesit.

21. Në datën 20.6.2020, trupi gjykues vendosi¹⁴ rihapjen e hetimit administrativ për shkak të ndryshimit të anëtarit të trupit gjykues, si edhe vendosjen në dispozicion të komisioneres Suela Zhegu, të rezultateve të hetimit administrativ dhe të dokumentacionit të plotë, pjesë e dosjes së hetimit administrativ.

22. Pasi komisionerja Suela Zhegu shprehu dakordësinë me rezultatet e hetimit administrativ të dërguara më parë subjektit, me vendim qarkullues¹⁵, në datën 22.6.2022, trupi gjykues vendosi: i) mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, bazuar në rezultatet e hetimit administrativ, të paraqitura nga relatorja e çështjes, me të cilat subjekti është njohur dhe i ka kaluar barra e provës në datën 4.5.2022, si edhe ka

⁶ Shpjegimet dhe provat e depozituara, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.5.2022.

⁷ Vendim i ndërmjetëm nr. ***, datë 26.5.2022.

⁸ Vendim i ndërmjetëm nr. ***, datë 6.6.2022.

⁹ Kërkesë e depozituar në datën 6.6.2022, nëpërmjet postës elektronike, nga avokatja A.S, konfirmuar si përfaqësuese ligjore e caktuar nga subjekti, me anë të prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. E.K.

¹⁰ Vendim i ndërmjetëm nr. ***, datë 6.6.2022.

¹¹ Vendimi i Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit nr. ***, datë 14.6.2022 (protokolluar me nr. ***), “Për ngritjen e trupit gjykues që do të marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit A.Y., dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit, Altin Abdiu, për përjashtimin e komisioneres Etleda Çiftja nga trupi gjykues që rivlerëson çështjet e tyre”.

¹² Vendimi i datës 17.6.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.6.2022.

¹³ Vendim i Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit me nr. ***, datë 17.6.2022 (protokolluar me nr. ***), “Për caktimin me short të anëtarit të trupit gjykues në çështjen e subjektit të rivlerësimit Altin Abdiu”.

¹⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. ***, datë 20.6.2022.

¹⁵ Vendimi i ndërmjetëm nr. ***, datë 20.6.2022.

paraqitur prapësimet e tij në datën 24.5.2022; (ii) të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

23. Seanca e tretë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 24.6.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

24. Subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesja ligjore e tij, znj. A.S, morën të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe pretendimet e tyre në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe mbi rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

25. Zoti Altin Abdiu ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

25.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

26. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

26.1. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe të proporcionalitetit, parime këto që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë ligj përcaktohet angazhimi i organeve kompetente ndihmëse në procesin e rivlerësimit që kryhet nga Komisioni.

26.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

26.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

26.4. Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit profesional.

26.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017¹⁶ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të

¹⁶ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që

mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja bashkë me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite, si dhe aktet mbështetëse si dokumentacion bashkëlidhur raportit; b) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; c) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; ç) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; d) denoncimet e publikut; e) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, si dhe nëpërmjet postës elektronike për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së të ardhurave, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e saj.

27.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

27.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave, të cilat janë deklaruar si burim krijimi të pasurive. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI më 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme:

28. Pasuria e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 110 m², ndodhur në Tiranë, në Njësinë Bashkiake nr. ***, rruga “****”, ndërtesa nr. ***, hyrja ***, nr. ***. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar në datën 19.11.2002. Si vlerë të saj ka deklaruar shumën 465,953 lekë, për të cilën shpjegon se është përcaktuar nga çmimi i 1/2 pjesë të apartamentit, i cili ka qenë më parë në pronësi të tij dhe familjarëve të tij (me të cilën është shkëmbyer kjo pasuri) dhe shumës prej 280,000 lekësh, e cila përfaqëson investimin në shtesën e bërë prej tij mbi këtë pasuri.

28.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, duke shpjeguar në mënyrë kronologjike si më poshtë vijon:

- i. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Tirana ***, zona kadastrale ***, me nr. pasurie ***, datë 1.7.1999, ka qenë bashkëpronar me 3/10 pjesë me babain dhe nënën e tij, F dhe K.A, të cilët zotëronin secili 3/10

përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

pjesë dhe me motrën e tij, R.A, e cila zotëronte 1/10 pjesë, të një apartamenti me sipërfaqe 114,3 m², ndodhur në Tiranë, në rrugën “****”, pallati ***, shkalla ***, ap. ***.

- ii. Pasuria e sipërcituar (apartamenti në rrugën “****”), e ka origjinën nga blerja e apartamentit me sipërfaqe fillestare 76.7 m², me kontratën e shitblerjes së datës 7.9.1993, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa nr. ***, në cilësinë e palës shitëse dhe subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij, në cilësinë e palës blerëse. Subjekti ka deklaruar se bazuar në kontratën e shitblerjes dhe në referim të ligjit të kohës, si fëmijë madhor, rezulton bashkëpronar me 1/3 pjesë së kësaj pasurie. Si vlerë të kësaj pasurie (apartamentit me sipërfaqe 76.7 m²) ka deklaruar shumën 13,520 lekë.
- iii. Në vazhdim, referuar kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.1999, të lidhur midis Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Tiranë, në cilësinë e palës shitëse dhe subjektit të rivlerësimit, prindërve dhe motrës së tij, në cilësinë e palës blerëse, apartamentit të mësipërm i është shtuar një sipërfaqe prej 37.6 m², nga ndërtimi i një shtese pallati, e cila u është shitur blerësve. Si vlerë të blerjes kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar shumën 358,386 lekë. Subjekti ka deklaruar se ka zotëruar 1/4 pjesë të kësaj shtese.
- iv. Apartamenti, së bashku me shtesën, është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tirana ***, në datën 1.7.1999, sipas certifikatës së pronësisë, me numër pasurie ***, volum ***, faqe ***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe të përgjithshme 114.3 m², në bashkëpronësi të subjektit me 3/10 pjesë, babait të subjektit me 3/10 pjesë, nënës së subjektit me 3/10 pjesë dhe motrës së subjektit me 1/10 pjesë. Si vlerë totale të blerjes së kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar shumën 371,906 lekë. Subjekti ka shpjeguar se më pas ky apartament është ndarë në dy apartamente, në të cilat ai rezulton bashkëpronar, si fëmijë madhor, në bazë të ligjit të kohës, duke zotëruar 3/10 pjesë.
- v. Këto dy apartamente të përshkruara si më sipër, me deklaratën noteriale nr. *** rep., të datës 19.11.2002, midis deklaruesve: (i) familjarëve Abdiu; dhe (ii) shtetasit R.H, administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., janë shkëmbyer me dy apartamente me hyrje më vete, me sipërfaqe të përgjithshme 200 m², të ndodhura në Tiranë, në bulevardin “****”, kulla nr. ***, kati *** (sot rruga “****”, ndërtesa nr. ***, hyrja ***).
- vi. Sipas deklaratës noteriale, kontrata e shkëmbimit midis këtyre pronave do të bëhej menjëherë pas regjistrimit të kullës nr. ***, në ZRPP-në Tiranë. Kjo deklaratë do të kishte fuqi ligjore deri në përpilimin e kontratës së shkëmbimit. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se deri datën e deklarimit nuk rezulton të jetë kryer regjistrimi i kësaj prone në hipotekë nga shoqëria e mësipërme.
- vii. Me pjesëtimin vullnetar, sipas deklaratës së datës 19.11.2002, njëri nga dy apartamentet e shkëmbyera, ai i shënuar me numrin *** në skicën planimetrike, me sipërfaqe 90 m², i paregjistruar në hipotekë, ka kaluar në pronësinë e subjektit që nga momenti i shkëmbimit (datë 19.11.2002).
- viii. Në muajin qershor të vitit 2013, në apartamentin i cili i ka kaluar në pronësi (referuar si më sipër), ka mbyllur një ballkon me vetratë xhami, duke u shtuar sipërfaqja e brendshme me 20 m². Si vlerë e vetratës së xhamit dhe e riparimeve të kryera është deklaruar shuma 280,000 lekë.
- ix. Për sa ka shpjeguar më sipër, subjekti deklaron se është pronar i apartamentit me sipërfaqe 110 m², të ndodhur në objektin e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në rrugën “****”, Tiranë, dhe si vlerë të kësaj pasurie ka llogaritur ½ e vlerës së

apartamentit të blerë nga EKB (të shkëmbyer) plus shpenzimet për mbylljen e ballkonit me vetratë xhami (vlera totale 465,953 lekë).

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

29. Në deklaratën fillestare të pasurisë¹⁷ (dorëzuar në ILDKPKI në muajin mars të vitit 2004) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron 100% pjesë takuese të pasurisë së llojit “apartament banimi”, me vlerë 4 milionë lekë, ndodhur në blv “***”, nr. ***, para Gjykatës. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: *nga këmbimi i dy apartamenteve te rruga “***”, P.***, dhe nga pjesëtimi vullnetar.* Deklaron se zotëron 100% pjesë takuese të kësaj pasurie.

29.1. Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë (këtej e në vijim DIP) të vitit 2013, subjekti ka deklaruar shtimin e sipërfaqes së apartamentit me 20 m², nga mbyllja e një verande me mur dhe vetrata, vlera 280,000 lekë. Burimi i krijimit të kësaj shume janë nga kursimet vjetore nga paga.

30. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: referuar përgjigjes së ZVRPP-së Tiranë rezulton se nuk janë bërë ndryshimet e pronësisë të apartamenteve të shkëmbyera.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri

31. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin/dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ¹⁸ për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, rezulton se:

- i. në datën 7.9.1993, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij kanë blerë¹⁹ nga Ndërmarrja Komunale Banesa nr. ***, Tiranë, pasurinë e llojit “apartament banimi” (nr. ***) me sipërfaqe 76.7 m², të ndodhur në rrugën “***”, pallatin nr. ***, Tiranë, për vlerën 13,520 lekë.
- ii. në datën 27.5.1999, subjekti i rivlerësimit së bashku me prindërit dhe motrën e tij, kanë blerë²⁰ nga Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria Rajonale Tiranë, pasurinë e llojit apartament banimi (nr.***), me sipërfaqe 37.6 m², të ndodhur në Tiranë, në rrugën “***”, pallati ***, shkalla ***, për vlerën 458,386 lekë.
- iii. në datën 1.7.1999, pas bashkimit të dy pasurive, apartamenteve të përshkruar si më sipër, është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie, referuar të cilit është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, prindërve dhe motrës së tij, pasuria e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 114.3 m². Rezulton se subjekti zotëron 3/10 pjesë takuese të kësaj pasurie.
- iv. në datën 19.11.2002, mes subjektit të rivlerësimit, prindërve dhe motrës së tij dhe shtetasit Rr.H, me cilësinë e administratorit të shoqërisë “***” sh.p.k., nënshkruhet deklarata noteriale²¹, sipas së cilës palët kanë shprehur dakordësinë për të shkëmbyer apartamentin në pronësi të familjes Abdiu (me dy hyrje më vete) të ndodhura në rrugën “***”, Tiranë, me dy apartamente me sipërfaqe 200 m², të ndodhura në blv. “***”, kulla nr. ***, kati i ***, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “***” sh.p.k., (pronë e saj). Gjithashtu, në këtë deklaratë përcaktohet se kontrata e shkëmbimit

¹⁷ Deklaratë e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie.

¹⁸ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting” (ndodhur në aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së).

¹⁹ Kontratë shitjeje e datës 7.9.1993, konfirmuar me vërtetimin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.1993, redaktuar nga noteri publik, znj. M.S.

²⁰ Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.1999, redaktuar nga noteri publik, znj. A.N.

²¹ Deklaratë noteriale me nr. *** rep., datë 19.11.2002, redaktuar nga noteri publik, znj. A.N.

midis këtyre pronave do të bëhet menjëherë pas regjistrimit të kullës ***, në ZVRPP-në Tiranë dhe se kjo deklaratë do të ketë fuqi ligjore deri në përpilimin e kontratës së shkëmbimit.

- v. në datën 19.11.2002, mes subjektit të rivlerësimit, prindërve dhe motrës së tij, është nënshkruar deklarata për pjesëtim vullnetar (shkresë e thjeshtë), në të cilin përcaktohet se: *“Sot në datë 19.11.2002 bëjnë pjesëtimin vullnetar të dy apartamenteve që kanë në bashkëpronësi, me sipërfaqe të përgjithshme 200 metra katrorë, kati ***, Kulla ***, të cilët ndodhen në rrugën ****, Tiranë, për shkak se këto dy apartamente nuk janë të regjistruara në hipotekë, si vijon: a) Altin Abdiu merr në pronësi apartamentin numër *** të shënuar në planimetrinë që i bashkëngjitet këtij akti me sipërfaqe 90 metra katrorë, i përbërë nga dy dhoma gjumi, një sallon, dy banjo dhe dy veranda; b) dërsa apartamenti tjetër me numër **** sipas skicës planimetrike i përbërë nga dy dhoma gjumi, një sallon, një guzhinë gatimi, dy banjo, dy veranda, me sipërfaqe të përgjithshme 110 metra katrorë, kalon në bashkëpronësi të F.A, K.A dhe R.A me nga 1/3 pjesë.”*

31.1. Siç u konstatua edhe më sipër, subjekti ka deklaruar se në vitin 2013 ka kryer investime mbi këtë pasuri, duke e shtuar sipërfaqen e saj me 20 m².

Pra, konstatohet se bazuar në dokumentacion dhe të dhënat e referuara si më sipër, subjekti, me dorëzimin e deklaratës “Vetting” ka deklaruar se zotëron pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 110 m², të ndodhur në Tiranë, në Njësinë Bashkiake nr. ***, rruga ****, ndërtesa nr. ***, hyrja ***, nr. **. Ndërsa, si vlerë të saj ka shënuar shumën 465,953 lekë, e cila referuar deklaramit i përgjigjet ½ së çmimit total për blerjen e apartamentit me të cilin është shkëmbyer kjo pasuri dhe vlerës prej 280,000 lekë si investim të kryer prej tij mbi këtë pasuri në vitin 2013.

31.2. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka referuar saktë çmimin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 37.6 m² nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 1999 dhe në këtë kuptim rezulton se gjithsesi, edhe sipas mënyrës së tij të përlllogaritjes së vlerës së pasurisë objekt vlerësimi, ai ka kryer deklarim të pasaktë të saj.

31.3. I pyetur nga Komisioni për adresat e banimit të tij nga momenti i marrjes së detyrës për herë të parë e në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se²² nga momenti që ka marrë detyrën deri në vitin 2002, ka banuar në adresën rruga ****, pallati ***, shkalla ***, apartamenti ***, apartament në të cilin ka qenë bashkëpronar me 3/10 pjesë, e vërtetuar kjo me Çertifikatë për vërtetim pronësie, numër pasurie ***, volum ***, faqja ***, zona kadastrale nr. ***, datë 1.7.1999. Nga viti 2003 deri në datë 20.12.2019 ka banuar në adresën: Njësia Bashkiake nr. ***, Bulevardi ***, Rr. ***, Ndërtesa ***, Hyrja ***, Kati ***, Apartamenti ***, Tiranë, në një apartament, të cilin e ka patur në pronësi bazuar në: Deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 19.11.2002 dhe Deklaratë për Pjestim Vullnetar, datë 19.11.2002. Nga data 24.12.2019 e në vazhdim, banon në një apartament të cilin e ka në posedim në bazë të aktmarrëveshjes siguruuese, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2019, me adresë Tiranë, ***, Rruga ****, pallati nr. ***, hyrja ***, kati i **.

31.4. ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri²³ informon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria e ndodhur në zonën kadastrale ***, vol. ***, faqe ***, e llojit “apartament” me sipërfaqe 114.3 m², në bashkëpronësi me prindërit. Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar për këtë pasuri, rezulton se në të figuron bashkëpronare me 1/10 pjesë edhe motra e subjektit dhe se ky apartament është

²² Referohu përgjigjes së pyetjes nr.1 të pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni (protokolluar me nr. *** prot., datë 24.3.2020, përgjigjet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit).

²³ Shkresa me nr. *** prot., datë 12.8.2020, protokolluar me nr. ***, datë 12.8.2020.

ai për të cilin subjekti referon se e kanë shkëmbyer me dy apartamentet e ndodhura në objektin e shoqërisë “****” sh.p.k.

31.5. Sa më sipër, rezulton se pasuria objekt shkëmbimi (apartamenti me sipërfaqe prej 114.3 m², në rrugën “****”) me pasurinë objekt vlerësimi (apartamentin te kulla e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k.), sipas përcaktimeve të bëra në deklaratën e datës 19.11.2002, figuron ende *de jure* e regjistruar në pronësi të familjes Abdiu.

31.6. Në vijim të verifikimeve të kryera, në kushtet kur babai i subjektit të rivlerësimit, për nga funksioni/et që ka pasur, ka qenë subjekt deklarues i interesave privatë, Komisioni kërkoi²⁴ nga ILDKPKI-ja dokumentacion shkresor lidhur me kontrolllet e mundshme të kryera ndaj z. F.A, si edhe të gjitha deklaratat e depozituara prej tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit²⁵rezulton se në deklaratën fillestare të pasurisë (depozituar në ILDKPKI në datën 10.3.2004), në seksionin “Pasuri të paluajtshme dhe e drejta reale mbi to”, z. F.A, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron 50% të pasurisë së llojit “apartament” me sipërfaqe 95 m², me vlerë 4 milionë lekë, të ndodhur në bulevardin “****”, Tiranë. Për këtë pasuri ka deklaruar se është ndërruar në fillim të vitit 2003 me dy apartamente të tjera më të vegjël. Pas pjesëtimit vullnetar të tyre disponon së bashku me bashkëshorten sipërfaqen e lartpërmendur. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, më specifikisht, në deklarimin e tij ka sqaruar se ky apartament së bashku me apartamentin që disponon djali, Altini, janë këmbyer me dy apartamente që kishin në rrugën “****”, pallati ***, shkalla e dytë. Diferenca e sipërfaqes së tyre është likuiduar me një kredi dhe me kursimet e tyre nga pagat.

31.7. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank”²⁶ rezulton se në datën 11.4.2001, është lidhur kontrata²⁷ e huas për blerje banese, mes degës së ish-Bankës së Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”) dhe shtetasit F.A (si huamarrës), nëpërmjet të cilës këtij të fundit i është akorduar shuma prej 2,500,000 lekësh hua, me objekt për blerje banese, me interes 3% në vit, me afat kthimi prej 15 vjetësh. Kjo kontratë huaje është bazuar në VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

31.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank” konstatohet se objekti plan investimi që lidhet me kredinë e akorduar është apartamenti me nr. ***, me sipërfaqe të përgjithshme prej 111 m², i ndodhur në bulevardin “****”, kulla nr. ***, shkalla ****, kati i *** banim, i porositur²⁸ në datën 20.11.2000 nga z. F. A, tek shoqëria “****” sh.p.k., për çmimin 6,600,000 lekë.

Në kontratën e sipërmarrjes është përcaktuar plani i pagesave si vijon: *pagesa e vlerës së apartamentit do të bëhet duke likuiduar vleftën prej 2,500,000 lekësh me kredinë e dhënë nga Banka e Kursimeve sipas shkallës së punimeve të kryera. Diferenca është likuiduar nga porositësi me pagesë të menjëhershme në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.*

31.9. Rezulton se pas disbursimit të kredisë, në datën 18.4.2001, z. F.A (babai i subjektit) ka transferuar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., në llogarinë e saj në ish - Bankën e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), shumën 2,500,000 lekë, me përshkrimin “*sa likujdojme kont.sipermarrje nr. *** noterizuar date 20.11.2000*”.

²⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 3.2.2022.

²⁵ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 25.2.2022, protokolluar me nr. *** prot., datë 25.2.2022.

²⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 14.5.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.5.2020; shkresa nr. *** prot., datë 1.3.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.3.2022.

²⁷ Kontratë huaje për blerje banese me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2001, redaktuar nga noteri publik, znj. N.K.

²⁸ Kontratë sipërmarrjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.11.2000, redaktuar nga noteri publik, L.K.

31.10. Komisioni konstaton se si kolateral për sigurimin e kësaj kredie është vendosur pasuria e llojit “apartament banimi” e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në bashkëpronësi të kredimarrësit me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten dhe vajzën e tij. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton se kredia me kushte lehtësuese e marrë nga z. F.A, në prill të vitit 2001, në ish-Bankën e Kursimeve është shlyer deri në datën 26.1.2012, datë në të cilën është bërë pagesa e fundit dhe mbyllja e kësaj kredie.

31.11. Sa më sipër, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, në datën 20.11.2000, ka porositur një apartament banimi në objektin e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., ndodhur në bulevardin “****”, kulla nr.***, shkalla ***, kati i *** banim. Ndërkohë, në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara në ILDKPKI, ai (babai i subjektit) ka deklaruar si adresë banimi: “*Njësia Administrative nr. ***, Bulevardi ***, kulla nr. ***, kati ***, Tiranë*”.

31.12. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI-ja²⁹ konstatohet se në shpjegimet e depozituara nga z. F.A, në përgjigje të kërkesës së bërë nga ILDKPKI-ja me nr. *** prot., datë 1.3.2005, ka deklaruar se *ai dhe bashkëshortja banojnë në një apartament në adresën e shënuar në formular (i referohet formularit të deklaramit të depozituar në ILDKPKI), ndërsa djali, Altini, madhor, banon në apartamentin e tij në po atë adresë. Këto apartamente janë shkëmbyer në datën 19.11.2002, me banesën që kanë përfitur nga privatizimi, që ndodhet në rrugën “****”, me firmën “****” sh.p.k., Tiranë. Meqenëse pallati ku banojnë tani nuk është i regjistruar akoma nga ndërtuesi, shkëmbimi është bërë me një deklaratë noteriale në të cilën thuhet se kontrata e deklaramit do të hartohet menjëherë pas regjistrimit të pallatit të ndërtuar nga firma “****” sh.p.k., Tiranë. Që nga data e lartpërmendur banesën që figuron në pronësi të tij e ka në përdorim shoqëria “****” sh.p.k., me drejtues R.H. Atë apartament ai e ka shitur pa kontratë shitje, me deklaratë noteriale tek dy familje që banojnë aktualisht në të.*

31.13. Sikurse konstatohet edhe më sipër, në deklaratën noteriale të datës 19.11.2002, referohet se apartamenti, pronë e familjes Abdiu, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, shkëmbehet me dy apartamente të ndodhura në objektin e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në rrugën “****”, kulla nr. ***, kati i ***.

31.14. Nisur nga faktet dhe rrethanat e parashtruara si më sipër, Komisioni kërkoi³⁰ nga subjekti shpjegime shtesë mbi marrëdhënien e tij dhe familjarëve të tij me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe/apo përfaqësuesin ligjor të saj, z. R.H.

31.14.1. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se³¹ *nuk ka qenë në dijeni për kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.11.2000, është vënë në dijeni rreth 6 muaj më parë, në zyrën e avokates së shoqërisë “****” sh.p.k, ku edhe është interesuar mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Kjo ka qenë arsyeja që nuk e ka deklaruar këtë kontratë. Për më tepër në kujtesën e të atit të subjektit kjo kontratë ishte anuluar, sepse administratori i shoqërisë ia kishte shitur një pale tjetër këtë apartament. Në këto kushte, shuma e paguar për kontratën e mësipërme, u dakordësua të përdorej për shkëmbimin e apartamenteve. Siç edhe është konstatuar, kjo shumë është paguar në datën 18.4.2001. Burimi ka qenë huaja e marrë nga babai pranë ish-Bankës së Kursimeve, e cila gjithashtu rezulton të jetë shlyer po nga ai.*

²⁹ Dokumentacioni i përcjellë nga ILDKPKI me shkresën nr. *** prot., datë 3.12.2021, protokolluar në KPK me nr. *** prot., datë 3.12.2021.

³⁰ Pyetja nr. 1 e pyetësorit nr. 3.

³¹ Referohu përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 (përgjigjet e pyetjes nr.1), dërguar nga subjekti me e-malin e datës 9.3.2022.

31.14.2. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar dokumente provuese³² dhe ka shpjeguar se *babai i ka deklaruar³³ se nuk ka asnjë djeni se në cilin objekt të ndërtuar nga shoqëria "****" sh.p.k, ndodhet kjo pasuri që i përket kontratës së sipërmarrjes të evidentuar më sipër. Në këto kushte nuk është kryer ndonjë veprim tjetër veç pagesës së përshkruar më sipër në lidhje me kontratën e sipërmarrjes.*

31.14.3. Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se *babai ka mbajtur marrëdhënie të vazhdueshme me shoqërinë e ndërtimit, edhe pas vdekjes së administratorit, me bashkëshorten e tij, znj. V.H, për të cilën ka djeni se ka qenë disa herë e dënuar për veprën penale "Mashtrimi" ndaj shtetasve të ndryshëm. Vazhdimisht shoqëria ka deklaruar se pasuritë janë në proces regjistrimi në ASHK, veprim i cili nuk është finalizuar ende. Pasuria në rrugën "****" rezulton aktualisht e regjistruar në emër të tij dhe familjarëve të tij për shkakun se deri në këto momente nuk është realizuar kontrata e shkëmbimit të pasurive, sepse ende pasuria e shoqërisë "****" sh.p.k., e shkëmbyer faktikisht, nuk është regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për shkak të problematikave të kësaj shoqërie dhe administratorëve të saj me ligjin. Sipas informacioneve që ka, pasuria në rrugën "****" përdoret nga dy familje sipas marrëveshjeve që ata kanë bërë me shoqërinë "****" sh.p.k, e cila rezulton poseduese e kësaj pasurie.*

Në mbështetje të deklarimeve të tij ka depozituar bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit, shkresën "kthim përgjigjeje" nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri, e datës 15.7.2021.

31.15. Me e-malin e datës 29.4.2022, dërguar Komisionit, subjekti ka depozituar kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., dhe nr. – kol., të datës 22.11.2001, duke sqaruar se kjo kontratë ka të bëjë me apartamentin e shkëmbyer në rrugën "****", të regjistruar në hipotekë në adresën: pallati ***, shkalla ***, kati ***, ap. ***, Tiranë, i cili figuron në pronësi të familjes Abdiu. Subjekti ka shpjeguar se kjo kontratë me sipërmarrës: shoqëria "****" sh.p.k, të përfaqësuar nga administratori Rr.H, porosites: R.B dhe A.Ç, është e shoqëruar me dy mandatarkëtimi të datave 26 dhe 27.11.2001, ku në brendësi të mandatit të datës 26.11.2001, shënohet se *"dy porositesit i kanë arkëtuar shoqërisë "****" sh.p.k., shumën 6.505.000 lekë, për blerjen e apartamentit 2+1 (me sipërfaqe 135 metra katrorë) tek Ap. i F. A."*³⁴ Pra, subjekti pretendon se nga përmbajtja e këtyre akteve rezulton se apartamenti në pronësi të familjes Abdiu, i regjistruar në hipotekë, i është shitur në shumën 46,800 dollarë amerikanë shtetasve R.B. dhe A.Ç, të cilët rezultojnë se e kanë paguar çmimin e shitjes.

31.16. Por, Komisioni konstaton se mandatpagesa e referuar nga subjekti nuk lidhet me kontratën e sipërmarrjes të nënshkruar nga palët, pasi rezulton se objekt kontrate është një apartament, i cili do të ndërtohej nga shoqëria "****" sh.p.k. Për më tepër, në kushtet kur deklarata noteriale për shkëmbimin e apartamenteve me shoqërinë "****" sh.p.k., është nënshkruar në datën 19.11.2002, kjo shoqëri nuk mund të merrte përsipër të shiste /t'i kalonte të drejtat të pasurisë së familjes Abdiu në vitin 2001, shtetasve R.B dhe A.Ç, pasi konstatohet nuk kishte asnjë të drejtë reale mbi të.

31.17. Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit shkresor të administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ të kryer për pasurinë objekt vlerësimi dhe burimet e deklaruara për krijimin e saj, konstatohet se:

³² Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 20.11.2000; kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.2001.

³³ Deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. E.Q.

³⁴ Kopje mandatesh, depozituar nëpërmjet postës elektronike, bashkëlidhur shpjegimeve të tij, të datës 29.4.2022.

- i. në deklaratën “Vetting”, subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe në mënyrë të plotë burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, pasi dy pasuritë e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., kanë si burim krijimi: (i) vënien në disponim të shoqërisë “****” të apartamentit në pronësi të familjes Abdiu; (ii) një kredi; dhe (iii) kursimet e familjes ndër vite.
- ii. ka dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e marrëdhënies së shkëmbimit të pasurisë objekt vlerësimi me apartamentin në pronësi të familjes Abdiu, kjo pasi: (i) referuar kontratës së sipërmarrjes të datës 20.11.2000, në këtë datë babai i subjektit ka kryer pagesën në shumën 4,100,000 lekë për blerjen e një apartamenti nga shoqëria “****” sh.p.k., ndërsa pjesa tjetër është likuiduar me disbursimin e një kredie bankare në prill të vitit 2001; (ii) subjekti pretendon se ka shkëmbyer një pasuri e cila ishte vendosur si kolateral për sigurim kredie, me dy pasuri të cilat ishin ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k.; (iii) apartamenti objekt shkëmbimi figuron edhe sot *de jure* në pronësi të familjes Abdiu; (iv) nuk janë përcaktuar saktësisht dhe me të dhëna të plota pasuritë, apartamentet të cilat janë përfituar nga familjarët Abdiu.
- iii. nisur nga fakti se në deklaratën fillestare të pasurisë subjekti ka deklaruar se disponon të drejta reale për pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 90 m², kjo në referim të deklaratës noteriale të nënshkruar me shtetasin Rr.H dhe deklaratës së pjesëtimit vullnetar të bërë me familjarët e tij, duket se në vitin 2013, subjekti ka kryer zaptim të sipërfaqeve të përbashkëta të pallatit dhe ndërtim pa leje, duke e shtuar sipërfaqen e apartamentit të tij me 20 m².

31.18. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare dhe të depozitonte prova të reja të mundshme mbi konstatimet e mësipërme, në funksion të provueshmërisë së ligjshmërisë mbi mënyrën e përfitimit dhe burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

32. Me anë të prapësimeve të depozituara në Komision, si edhe gjatë seancës dëgjimore të datës 24.6.2022, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet/argumentet e tij, si edhe ka depozituar prova të reja shtesë, me qëllim kundërshtimin e rezultateve të hetimit që lidhen me pasurinë objekt vlerësimi (apartamentit në Tiranë), të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

32.1. Së pari, subjekti parashtroi se apartamenti i sipërcituar është përfituar nga veprimi juridik i shkëmbimit të dy apartamenteve që anëtarët e familjes Abdiu zotëronin në rrugën “****”, Tiranë, me dy apartamente të ndërtuara nga shoqëria “****” sh.p.k., në Bul. “****” (sot rruga “****”) Tiranë, shkëmbim i cili është përshkruar në deklaratën noteriale të datës 19.11.2002 (deklaratën e cila do ketë fuqi ligjore deri në përpilimin e kontratës së shkëmbimit).

32.1.1. Sa i përket burimit të krijimit sqaron se ka deklaruar informacionin që dispononte. Pra, deklaroi se babai i tij, i cili ka kryer të gjitha veprimet me administratorin e shoqërisë, Rr.H, i ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale të vitit 2002 dhe se ai ka deklaruar ekzaktesisht faktet që pasqyrohen në këtë deklaratë.

Në vijim, parashtroi se gjatë hetimit administrativ është vënë në dijeni edhe për ekzistencën e kontratës së sipërmarrjes të datës 20.11.2000, lidhur midis babait të tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., për porositjen e një apartamenti, duke pretenduar se kjo kontratë është anuluar, sepse administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., z. R.H, këtë apartament ia ka shitur rreth dy muaj më pas, z. M.Z.

32.1.2. Subjekti parashtroi se nëpërmjet provave të depozituara, vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se apartamenti nr. ***, me sipërfaqe 110 m², në adresën, bulevardi “***”, shkalla nr. ***, kulla nr. ***, kati *** i banimit, rreth 2 muaj më pas i është shitur shtetasit M.Z, i cili banon aktualisht në këtë apartament.

Subjekti pretendon se, pavarësisht se në kontratën e sipërmarrjes së datës 20.11.2000, është shënuar se në datën e lidhjes së saj është kryer pagesa prej 4,100,000 lekësh, kjo pagesë faktikisht nuk rezulton të jetë kryer. Babai i ka shpjeguar se ky formulim në kontratë është bërë me qëllim marrjen e kredisë bankare, i cili ka qenë kusht i vendosur nga banka.

32.1.3. Në vijim ai ka sqaruar se në vitin 2001 zotëronin një pasuri në rrugën “***” të regjistruar në ZVRPP, e cila faktikisht ishte ndarë në dy apartamente, pasi në këtë pasuri ishin kryer edhe disa sipërfaqe shtesë³⁵. Sipërfaqja totale e pasurisë 159 m². Ka deklaruar edhe shpenzimet për ndërtimin e shtesës (objekt pa leje), në vlerën prej 872,303 lekësh.

32.1.4. Subjekti ka parashtuar se babai i ka shpjeguar se fillimisht kanë vendosur në mënyrë verbale për shkëmbimin e pasurive me shoqërinë “***” dhe se pritej që të kryhej regjistrimi i apartamenteve të “***” që të kryhej shkëmbimi. Por, meqenëse regjistrimi nuk po kryhej në atë kohë, megjithë premtimet e vazhdueshme nga shoqëria ndërtuese, u nënshkrua deklarata noteriale e vitit 2002, e cila realisht është nënshkruar disa muaj më pas nga momenti kur shkëmbimi *de facto* ishte kryer.

32.1.5. Subjekti deklaroi se, bazuar në provat e administruara prej tij, të vëna në dispozicion Komisionit, shoqëria “***” sh.p.k., dy apartamentet e shkëmbyera ia ka shitur: (i) njërin shtetasve R.B dhe A.Ç, me sipërfaqe 116 m², për shumën 46,800 USD; dhe (ii) tjetrin shtetasit Xh.A për shumën 18,000 USD. Pra, subjekti pretendon se shoqëria “***” sh.p.k., i ka shitur dy apartamentet të “***”, në total për vlerën 64,800 USD. Gjithashtu, subjekti sqaroi se shtetasit R.B dhe A.Ç e posedojnë edhe aktualisht këtë pasuri, ndërsa në apartamentin e dytë, referuar edhe aktit të verifikimit në terren, të datës 20.5.2022, të bërë nga eksperti gjeodet dhe vlerësues ing. A.S, është gjendur në banesë shtetasi Xh.B (dhëndri i Xh. A).

32.1.6. Pra, subjekti pretendon se shoqëria “***” i ka shitur dy apartamentet në “***” dhe ka marrë vlerën monetare nga blerësit, të referuar si më sipër, përpara se të nënshkruhej deklarata noteriale e shkëmbimit, pasi siç e ka theksuar edhe më sipër, pasuritë *de facto* ishin shkëmbyer më parë.

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se verbalisht midis babait të tij dhe shtetasit R.H është rënë dakord (siç i ka shpjeguar së fundmi babai) që shuma prej 2,500,000 lekësh (vlerë e përfituar nga kredi) që babai kishte paguar për kontratën e sipërmarrjes së datës 20.11.2000, do të përdorej për të realizuar shkëmbimin e dy apartamenteve në pronësi të shoqërisë “***”, me pasurinë që ai dhe familjarët e tij kishin në rrugën “***”.

32.1.7. Pra, si përfundim subjekti ka deklaruar se pasuria objekt vlerësimi ka si burim (i) shkëmbimin e dy apartamenteve në rrugën “***”; (ii) të ardhurat në shumën 2,500,000 lekë të përfituara nga babai i tij nga kredia e marrë dhe në vijim pjesëtimin vullnetar të bërë mes familjarëve për dy apartamentet e përfituara nga shoqëria “***” sh.p.k.

32.1.8. Gjithashtu ka deklaruar se nuk ka kontribut në blerjen e kësaj pasurie, pasi rrjedh nga shkëmbimi i një pasurie të përfituar me ligjin e privatizimit si fëmijë madhor, shtesës së ndërtuar dhe shitur nga Enti Kombëtar i Banesave (për të cilën shprehet se pagesën e

³⁵ Konstatuar kjo sipërfaqe ndërtimi prej 44.7 m², në aktin e verifikimit në terren, të datës 20.5.2022, të bërë nga eksperti gjeodet dhe vlerësues ing. A. S (depozituar nga subjekti me dërgimin e prapësimeve), si shtesë në krahun verior dhe krahun perëndimor të apartamentit në rrugën “***”, Tiranë, e paregjistruar në ASHK.

ka kryer babai), si edhe pagesës së shumës prej 2,500,000 lekësh nga babai i tij. I vetmi kontribut i tij është pagesa prej 280,000 lekësh për fasadën e xhamit në vitin 2010.

32.2. Së dyti, deklararon se marrëdhënia e shkëmbimit të dy apartamenteve është materializuar në një sërë dokumentesh të administruara gjatë hetimit administrativ dhe të depozituara prej tij pas kalimit të barrës së provës. Bashkëlidhur prapësimeve, me qëllim provueshmërinë e deklarimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentet si më poshtë:

- i. Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 8.2.2001, lidhur mes shoqërisë “****” sh.p.k., dhe shtetasit M.Z (sipas së cilës referohet edhe porositja e apartamentit nr. ***, në kullën nr. ***, të objektit të ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në bulevardin “****”, Tiranë);
- ii. Deklaratë noteriale të shtetasit M.Z³⁶, datë 25.3.2022, shoqëruar me kopje të noterizuar të librezës së energjisë elektrike nr. kontrate ***, të lidhur me OSHEE dhe kopje të noterizuar të kontratës nr. ***, lidhur me UKT-në, të shtetasit M.Z;
- iii. Aktkonstatimi i datës 20.5.2022, nga ekspert gjeodet i licencuar (sipas të cilit eksperti ka bërë verifikimin në vend të pasurisë/pasurive në “****” dhe cilësimin e shtetasve që i posedojnë ato);
- iv. Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., datë 22.11.2002, për porositjen e një apartamenti nga shtetasi R. B dhe A.Ç tek shoqëria “****” (apartamenti i cili ishte në pronësi të familjes Abdiu) dhe dy mandatar-këtime të datave 26 dhe 27.11.2001;
- v. Deklaratë noteriale të shtetasit R.B³⁷, e datës 6.5.2022;
- vi. Deklaratë noteriale e shtetasit S.Z³⁸, datë 7.5.2022, banor në pallatin në rrugën “****”;
- vii. Certifikatë familjare të familjes së z. R.B, lëshuar në datën 17.5.2022, ku shënohet ndër të tjera se: *“kjo familje ka ardhur nga njësi nr. *** pa adresë, sipas aktit nr. ***, datë 31.5.2002, në njësinë nr. ***, pallati****, shkalla nr. ***, apartamenti nr. ****”*;
- viii. Vërtetim nga Njësia Administrative nr. ***, datë 17.5.2022, në bazë të të cilit konfirmohet se shtetasi R.B është banor i Njesisë Administrative nr. ***, rruga “****”;
- ix. Kontratë e datës 6.3.2019, të lidhur nga shtetasi R.B, me shoqërinë “****”;
- x. Mandatar-këtimi nr. ***, datë 16.11.2002 (dorëzuar nga shtetasi Xh.A), sipas të cilit ai i ka shpjeguar se i ka paguar shtetasit R.H, shumën 18,000 USD, për blerjen e apartamentit 1+1, të z. F.A, (siç është shënuar në mandate);
- xi. Deklaratë noteriale³⁹, e datës 17.5.2022, të shtetasve M.B dhe Xh.A, si edhe certifikatë familjare e z. Xh.B;
- xii. Prokurë e posaçme⁴⁰, e datës 13.12.2021, në bazë të të cilës shtetasit R.B dhe Xh. A, kanë marrë nga z. F.A, të drejtat që kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme në banesat që posedojnë.

32.2.1. Subjekti ka sqaruar se z. R.H nuk jeton më, prandaj ka qenë në pamundësi objektive të paraqesi dokumente të tjera shtesë nga shoqëria “****” sh.p.k., për të provuar marrëdhënien e z. R.H me shtetasit R.B dhe Xh.A, por edhe detaje të mëtejshme për marrëdhënien që babai i tij ka pasur me këtë shoqëri. Gjithashtu, ai është munduar të kontaktojë edhe administratoren aktuale të kësaj shoqërie, për të cilën siç ka ardhur në dijeni se vazhdimisht ka probleme me organet e drejtësisë.

³⁶ Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. E.Q.

³⁷ Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.5.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. E. Q.

³⁸ Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.5.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. F. Sh.

³⁹ Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.5.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. F. Sh.

⁴⁰ Prokurë e Posaçme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.12.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. E.Q.

32.2.2. Si konkluzion, në përgjigje të pikës 2 të barrës së provës për këtë pasuri, subjekti pretendon se nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, si edhe referuar dokumentacionit të depozituar prej tij bashkëlidhur prapësimeve, rezulton se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se marrëdhënia e shkëmbimit e vitit 2002 (e pasqyruar në deklaratën noteriale të këtij viti) është e vërtetë dhe se është dokumenti mbi bazën e të cilit e ka poseduar këtë pasuri, kontrata e shkëmbimit, nuk është realizuar për faj të shoqërisë ndërtuese (e cila nuk e ka regjistruar në ZRPP objektin e ndërtuar prej saj).

32.3. Së treti, ka argumentuar se apartamenti në fjalë nuk është i regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në vitin 2013, vetëm ka mbyllur me vetrata alumini ballkonin e apartamentit dhe ka vlerësuar (duke mos pasur edhe njohuritë e duhura inxhinierike) se sipërfaqja e apartamentit është rritur. Deklarimi është kryer me qëllim për të pasqyruar sa më saktësisht të gjitha ndryshimet e bërë në apartament. Mbyllja me vetrata e ballkonit është bërë edhe nga banorë të tjerë të pallatit.

32.4. Në vijim parashtron se nuk ka kryer ndërtim pa leje, pasi në referim të legjislacionit në fuqi përjashtohet nga detyrimi për t'u pajisur me leje punimesh për shkak të madhësisë, natyrës dhe efektit të vogël apo të kufizuar të zhvillimit.

32.5. Në mbështetje të parashtrimeve të tij ka depozituar si provë të re shtesë deklaratën noteriale të datës 9.5.2022, e administratorit të pallatit, z. B. B⁴¹, i cili ka deklaruar se në objekt nuk është kryer ndonjë ndërtim pa leje dhe nuk është zaptuar asnjë sipërfaqe e ambienteve të përbashkëta nga ana e shtetasit Altin Abdiu.

Arsyetimi ligjor, analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

33. Referuar pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

33.1. Referuar pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarinimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

33.2. Formulari i deklarinimit të pasurisë për rivlerësimin, shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, vendos detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklarinin e të gjitha pasurive të akumuluar ndërr vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

33.3. Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarinimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

33.4. Komisioni vëren se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është pronar i apartamentit me sipërfaqe 110 m², të ndodhur

⁴¹ Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.5.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. F. Sh.

në objektin e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në rrugën “****”, Tiranë, të përfituar prej tij nëpërmjet shkëmbimit, e në vijim pjesëtimit vullnetar dhe mbylljes me vetrata të verandës prej 20 m².

33.5. Referuar nenit 757 të Kodit Civil, shkëmbimi është kontrata që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues tek tjetri. Pra, kontrata e shkëmbimit është ajo kontratë, ku palët kontraktuese janë të detyruara reciprokisht që t’i dorëzojnë njëra-tjetrës sende të caktuara të cilat këmbehen dhe ato fitojnë respektivisht të drejtën e pronësisë mbi këto sende.

33.6. Në vijim, trupi gjykues arsyeton se shkëmbimi paraqitet si një kontratë e dyanshme dhe reale, sepse quhet e lidhur kur palët arrijnë përputhjen e vullneteve dhe bëhet dorëzimi i sendeve, duke krijuar të drejtat dhe detyrime reciproke për secilën prej tyre. Nëse objekt i shkëmbimit janë pasuritë e paluajtshme, kjo kontratë bëhet konsensuale dhe formale për shkak të detyrimit që përcakton neni 83 i Kodit Civil⁴².

Pra, rezulton se pronësia mbi një send të paluajtshëm mund të fitohet me anë të kontratës formale të shkëmbimit, nëpërmjet të cilës bëhet kalimi i ndërsjellë i pronësisë mbi sendet e shkëmbyera dhe se palët duhet t’i dorëzojnë njëra-tjetrës sendet e caktuara për këmbim.

33.7. Vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se sipas deklaratës noteriale, kontrata e shkëmbimit midis këtyre pronave do të bëhet menjëherë pas regjistrimit të kullës nr. ***, në ZRPP-në Tiranë dhe se kjo deklaratë do të ketë fuqi ligjore deri në përpilimin e kontratës së shkëmbimit. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon se deklarata noteriale e datës 19.11.2002, nënshkruar mes familjarëve Abdiu dhe shtetasit R.H (administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.), nuk mund të jetë dokumenti mbi bazën e të cilit subjekti i rivlerësimit dhe/apo familjarët e tij të kenë fituar/fitojnë pronësinë mbi apartamentet e ndërtuara nga shoqëria “****” sh.p.k.

33.8. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, subjekti i rivlerësimit nuk gëzonte tagrat e plota të pronësisë mbi pasurinë objekt vlerësimi. Për më tepër, Komisioni vëren se në momentin e nënshkrimit të deklaratës së shkëmbimit të pasurive, pasuria e llojit “apartament banimi”, e ndodhur në rrugën “****”, në pronësi të familjarëve Abdiu, ka qenë vendosur si kolateral për sigurimin e kredisë së marrë nga z. F.A, kredi e marrë pikërisht për porositjen e një apartamenti nga shoqëria “****” sh.p.k.

33.9. Rezulton se referuar kontratës së hipotekimit⁴³ të datës 11.4.2001, subjekti i rivlerësimit, ka shprehur dakordësinë e tij që apartamenti i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në të cilin ai zotëronte 3/10 pjesë takuese, të vendosej si kolateral për sigurimin e kredisë së marrë nga babai i tij në Bankën e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”).

Siç u konstatua më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit bankar, rezulton se kredia e marrë nga babai i tij në prill të vitit 2001, në ish-Bankën e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), është shlyer deri në datën 26.1.2012, datë në të cilën është bërë pagesa e fundit dhe mbyllja e kësaj kredie.

33.10. Gjithashtu, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në deklarimin e pasurisë së llojit vilë dykatëshe në G, ndër të tjera subjekti ka referuar se sipas kontratës së huas për blerje banese me nr. ***, datë 11.4.2001, babai i subjektit, F.A, ka marrë hua nga Dega e Bankës së Kursimeve Tirana ***, shumën 2,500,000 lekë,

⁴² Në nenin 83 të Kodit Civil përcaktohet se: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë”.

⁴³ Kontratë hipotekimi me nr. *** rep., *** kol., datë 11.4.2001, redaktuar nga noteri publik, znj. N.K.

e cila është shlyer përfundimisht në vitet e fundit. Në dritën e këtyre fakteve, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të plotë se pasuria në pronësi të familjes së tij nuk mund të shkëmbehet me apartamentet e shoqërisë “****” sh.p.k., për sa kohë ajo ka qenë vendosur si kolateral për sigurim kredie, për blerje apartamenti nga babai i tij, të porositur pikërisht te shoqëria “****” sh.p.k.

33.11. Komisioni çmon të theksojë faktin se nuk ekziston⁴⁴ dokument mbi bazën e të cilit të provohet dorëzimi i këtyre sendeve pas dhënies së pëlqimit për shkëmbimin e tyre (si p.sh., me procesverbal dorëzimi etj.), reciprokisht te familjarët Abdiu dhe te shoqëria “****” sh.p.k. Po ashtu, rezulton se në deklaratën e shkëmbimit nuk është pasqyruar dokumentacioni mbi bazën e të cilit palët dispononin të drejta pronësie/reale mbi pasuritë e dakordësuara për shkëmbim, si edhe nuk janë përcaktuar saktësisht dhe me të dhëna të plota pasuritë, apartamentet objekt shkëmbimi.

33.12. Subjekti ka referuar si pengesë për nënshkrimin e kontratës së shkëmbimit, mungesën e regjistrimit të pasurive nga shoqëria “****” sh.p.k., dhe se për këtë arsye pasuria e ndodhur në rrugën “****”, është ende e regjistruar në emër të tij dhe familjarëve të tij. Por, Komisioni vëren se të paktën deri në janar të vitit 2012, në rrethana hipotetike, vetë pasuria e familjarëve Abdiu nuk mund të ishte objekt kontrate shkëmbimi, në kushtet kur mbi të ishte vendosur barrë hipotekore për sigurim kredie (mund të kryhej shkëmbimi nëse paguhej kredia dhe lirohej pasurie, si edhe nëse banka jepte pëlqimin e saj për shkëmbimin e pasurive).

33.13. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni vëren se vetë subjekti, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, si edhe gjatë seancës dëgjimore të datës 24.6.2022, ka pranuar se ka pasaktësi në deklarin e tij lidhur me këtë pasuri, kjo kryesisht e lidhur me dijeninë e tij mbi përdorimin e shumës prej 2,500,000 lekësh të marrë nga babai i tij në vitin 2001. Si përfundim, subjekti ka delaruar se si burim krijimi për pasuritë e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., kanë shërbyer (i) shkëmbimi i dy apartamenteve në rrugën “****”; (ii) të ardhurat në shumën 2,500,000 lekë të përfituara nga babai i tij nga kredia e marrë; dhe në vijim (iii) pjesëtimi vullnetar i bërë mes familjarëve.

33.14. Rezulton se sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.11.2000, babai i subjektit, z. F.A, ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme prej 111 m², i ndodhur në Tiranë, bulevardin “****”, kulla nr. ***, shkalla ***, kati i *** banim, me nr. ***, për çmimin prej 44,400 USD (konvertuar në shumën rreth 6,600,000 lekë). Siç u konstatua më sipër, në kontratën e sipërmarrjes është përcaktuar plani i pagesave si vijon: pagesa e vlerës së apartamentit do të bëhet duke likuiduar vleftën prej 2,500,000 lekësh me kredinë e dhënë nga Banka e Kursimeve, sipas shkallës së punimeve të kryera. Diferenca është likuiduar nga porositësi me pagesë të menjëhershme në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.

33.15. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në momentin e lidhjes së kontratës nuk është kryer nga babai i tij pagesa e shumës 4,100,000 lekë (diferenca mes çmimit të pasurisë dhe vlerës së pasqyruar si të paguar me transfertë bankare), pasi përcaktimi në kontratë është bërë me qëllim përfitimin e kredisë nga babai i tij dhe se për më tepër apartamenti i porositur nga babai i tij i është shitur një shtetasit tjetër dy muaj më pas.

⁴⁴ Vetë subjekti në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni ka deklaruar se: “...Nuk janë përpiluar procesverbale mbi dorëzimin e këtyre pasurive për shkakun se në atë periudhë sipas shpjegimeve të administratorit të kësaj shoqërie Rr.H, regjistrimi në hipotekë i pasurisë së shoqërisë “****” do të bëhet shumë shpejt dhe menjëherë pas regjistrimit të kësaj pasurie do të bëhet kontrata e shkëmbimit”.

33.16. Referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë: “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”. Ndërsa në nenin 660 i Kodit Civil, parashikohet se: “Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”.

33.17. Në analizë të dispozitave të mësipërme, provave të administruara, si dhe duke u mbështetur në parashikimin e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellët palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”, trupi gjykues çmon se mbeten të karakterit deklarativ dhe për pasojë të paprovuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “***” sh.p.k., në datën 20.11.2000, nuk është paguar nga babai i tij shuma prej rreth 4,100,000 lekë, në funksion të shlyerjes së çmimit të pasurisë objekt kontrate.

Për më tepër, nuk rezulton që kjo kontratë sipërmarrjeje të jetë revokuar apo të jetë pasuar nga ndonjë dokument tjetër i nënshkruar mes palëve, ku të qartësohej dhe saktësohej ecuria e ndryshme e kësaj marrëdhënieje.

33.18. Gjithsesi, nga analizimi në harmoni i deklarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit me dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ, trupi gjykues çmon se shuma prej 4,100,000 lekësh (pasqyruar si pagesë e këstit të parë në funksion të kontratës së porosisë të lidhur nga babai i subjektit me shoqërinë “***” sh.p.k., në vitin 2000) ka shërbyer si burim për krijimin e pasurive të përfituara prej familjarëve Abdiu nga shoqëria “***” sh.p.k., sipas vetëdeklarimit të bërë, të dy apartamenteve të ndodhura në kullën nr. ***, kati i ***, të objektit të ndërtuar nga kjo shoqëri në bulevardin “***”, Tiranë, pasuri të cilat në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” kanë qenë në posedim të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij. Kjo, vlerësuar edhe në konsideratë të deklarimeve kontradiktore të bëra nga subjekti lidhur me mënyrën e përfitimit të pasurisë objekt vlerësimi, si edhe të faktit të njohur botërisht dhe të pranuar edhe nga vetë subjekti se shoqëria “***” sh.p.k., në vazhdimësi ka pasur problematika lidhur me transaksionet e kryera dhe përpilimin e dokumentacionit ligjor në shitjen e pasurive të ndodhura në objektet e ndërtuara prej saj.

33.19. Sa më sipër, trupi gjykues i qëndron konstatimit fillestar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kundërshtim me kushtet e nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

Në vijim të analizimit të marrëdhënies së shkëmbimit mes familjarëve Abdiu dhe shoqërisë “***” sh.p.k., Komisioni vlerëson se kemi të bëjmë me një lloj të veçantë kompensimi me shkëmbim, pasi në këtë rast sendet e pretenduara si të shkëmbyera nuk kanë të njëjtën vlerë. Konstatohet se pala që ka marrë sendin me vlerë më të madhe (familja Abdiu) i ka paguar palës tjetër (shoqërisë “***” sh.p.k.) një shumë parash në kompensim. Në vlerësimin e trupit gjykues, ky lloj veprimi konsiderohet si shkëmbim, por jo në rastet kur kompensimi është po aq i madh sa objekti kryesor i kontratës apo më i madh. Në këto raste do të jemi përpara kontratës së shitjes.

33.20. Vlen të rithkesohet se babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se apartamenti në posedim të tij te pallati i ndërtuar nga shoqëria “***” sh.p.k., së bashku me

apartamentin që disponon djali, Altini, tek i njëjti pallat, janë këmbyer me dy apartamente që kishin në rrugën “****”, pallati ***, shkalla e *** dhe se diferenca e sipërfaqes së tyre është likuiduar me një kredi dhe me kursimet e tyre nga pagat. Në këtë kontekst, kompensimi në vlerën 6,600,000 lekë i bërë në favor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., është pothuajse i përafërt me vlerën e objektit kryesor të marrëdhënies së shkëmbimit (apartamentit në “****”). Pra, kemi të bëjmë më shumë me një marrëdhënie shitblerjeje pasurie sesa një marrëdhënie shkëmbimi.

33.21. Megjithëse subjekti pretendon se në apartamentin e tij dhe familjarëve të tij të ndodhur në “****” ishte ndërtuar edhe një shtesë pa leje, nuk u provua koha/periudha e ndërtimit të saj. Duket se kjo shtesë nuk ka ekzistuar në momentin e marrjes së kredisë nga babai i subjektit të rivlerësimit, me qëllim financimin e blerjes së një apartamenti nga shoqëria “****” sh.p.k., pasi nuk është përmendur në raportin e vlerësimit të pasurisë së lënë kolateral për marrjen e kredisë të datës 5.12.2000 (pjesë e dosjes së kredisë). Komisioni konstaton se kjo shtesë pa leje e pretenduar si e ndërtuar para shkëmbimit të pasurive, duke i rritur vlerën apartamentit në pronësi të familjarëve Abdiu, nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, si pjesë përbërëse e pasurisë së shkëmbyer.

33.22. Pasi u ndal në analizimin dhe vlerësimin e shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti, lidhur me shitjen nga shoqëria “****” sh.p.k., të apartamentit/apartamenteve në rrugën “****”, Tiranë, të pretenduara si të përfituara me shkëmbim, trupi gjykues çmon se kjo shoqëri nuk mund të ofronte për shitje/t’i shiste shtetasve të tjerë këto pasuri pa disponuar titull pronësie/të drejta reale mbi to dhe për më tepër duket jashtë çdo logjike që blerësit e pretenduar të paguanin çmimin e blerjes së këtyre pasurive një shoqërie, e cila nuk gëzonte asnjë tagër mbi to. Sjellim në vëmendje këtu se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shoqëria “****” sh.p.k., ua ka shitur apartamentet këtyre shtetasve rreth një vit para nënshkrimit të deklaratës së shkëmbimit të pasurive mes palëve (shoqërisë “****” sh.p.k. dhe familjarëve Abdiu).

33.23. Si konkluzion, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, prapësimeve dhe dokumentacionit të depozituar pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si edhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe përfaqësuesja ligjore e tij gjatë seancës dëgjimore të datës 24.6.2022, trupi gjykues nuk u bind mbi vërtetësinë e marrëdhënies së shkëmbimit mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe familjarëve Abdiu, kjo pasi, përveçse sa u arsyetua më sipër, rezultojnë e provuar se: (i) babai i subjektit kishte lidhur më parë një kontratë porosie me shoqërinë “****” sh.p.k., dhe kishte kryer pagesa në funksion të kësaj kontrate; (ii) pasuria objekt shkëmbimi (pasuria e familjes Abdiu), ishte vendosur si kolateral për sigurim kredie; (iii) apartamenti objekt shkëmbimi figuron edhe sot *de jure* në pronësi të familjes Abdiu; (iv) në deklaratën e shkëmbimit nuk është pasqyruar dokumentacioni mbi bazën e të cilit palët dispononin të drejta pronësie/reale mbi pasuritë e dakordësuara për shkëmbim, si edhe nuk janë përcaktuar saktësisht dhe me të dhëna të plota pasuritë, apartamentet objekt shkëmbimi; si edhe (v) në deklaratën e shkëmbimit nuk është referuar fakti i dhënies së një vlere monetare në funksion të kësaj marrëdhënieje (të paktën sipas vetëdeklarimit të subjektit, shoqërisë “****” sh.p.k., babai i tij i kishte dhënë më parë shumën 2,500,000 lekë, krahas apartamentit në “****”, në funksion të përfitimit të dy pasurive në objektin e ndërtuar prej saj).

33.24. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në lidhje me mënyrën e fitimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kundërshtim me kushtet e nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

Sa i përket shtesës së sipërfaqes prej 20 m², të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2013, Komisioni konstatoi se në DIP/2013, por edhe në deklaratën “Vetting” subjekti ka referuar se kjo sipërfaqe shtesë ka ardhur pasi ai ka mbyllur verandën/balkonin me vetrata xhami.

33.25. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shtuar sipërfaqen e brendshme të banesës së tij me 20 m². Pra, nëse fillimisht kishte deklaruar apartamentin me sipërfaqe 90 m², në vitin 2013 pas këtij ndryshimi, ka deklaruar se apartamenti ka sipërfaqen prej 110 m².

33.26. Komisioni vëren se në deklaratën e shkëmbimit të pasurive të vitit 2002 është referuar se familjarët Abdiu do të përfitojnë dy apartamente me sipërfaqe totale prej 200 m², ndërkohë që në deklarimin fillestar të pasurisë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se zotëron apartamentin me sipërfaqe 90 m², ndërsa babai i tij apartamentin me sipërfaqe prej 95 m², si rrjedhojë e kësaj marrëdhënieje shkëmbimi. Pra, referuar deklaratimeve të tyre konstatohet se familjarët Abdiu deklarojnë se zotërojnë dy apartamente me sipërfaqe totale prej 185 m², pra rreth 15 m² më pak nga çka ishte dakordësuar në deklaratën e shkëmbimit.

33.27. Në këtë këndvështrim, si edhe duke pasur në konsideratë faktin se të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi janë kryesisht të karakterit deklarativ, për sa kohë për godinën ku ndodhet kjo pasuri nuk rezultojnë të ketë aktkolaudimi dhe se është e pajisur në regjistrat hipotekorë, si rrjedhojë edhe apartamenti në fjalë është i pajisur, Komisioni nuk arriti të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se subjekti i rivlerësimit mund të ketë bërë zaptim të sipërfaqeve të përbashkëta dhe ndërtim pa leje.

33.28. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, si edhe pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, gjendet bindës deklarimi i subjektit se shtesa e sipërfaqes së apartamentit të deklaruar prej tij në vitin 2013, ka ardhur si rezultat i mbylljes me vetratë xhami të balkonit/verandës pjesë përbërëse të apartamentit të tij.

33.29. Në analizë përfundimtare të marrëdhënies së deklaruar dhe asaj të dokumentuar me shoqërinë “****” sh.p.k., dhe familjarëve Abdiu, si edhe duke pasur në konsideratë deklaratimet kontradiktore të bëra në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mënyrën e përfitimit dhe burimin e krijimit të dy pasurive, apartamenteve të ndodhura në objektin e shoqërisë “****” sh.p.k., në bulevardin “****”, Tiranë (njëri prej të cilëve është pasuria objekt vlerësimi), Komisioni arrin në përfundimin se veprimet dhe deklaratimet e tij kanë pasur si qëllim bërjen të pamundur të verifikimit të mënyrës së përfitimit dhe burimit real të krijimit të këtyre pasurive.

34. Pasuria e llojit “vilë” dykatëshe (një kat plus papafingo), e ndodhur në fshatin G, Kavajë. Subjekti deklaroi se vlera e kësaj pasurie është rreth 8,000,000 lekë dhe se zotëron 1/3 pjesë takuese të saj.

Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se sipërfaqja e ndërtesës së katit të parë është 93 m², sipërfaqja e truallit është 489,47 m² dhe se kjo vilë është regjistruar me certifikatë për vërtetim pronësie në datën 26.7.2016, në ZVRPP-në Kavajë, zona kadastrale ***, me nr. pasurie ***. Sipas certifikatës së pronësisë është regjistruar vetëm kati i parë me sipërfaqe 93 m², por nuk është regjistruar kati i dytë papafingo.

34.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, duke shpjeguar në mënyrë kronologjike si më poshtë vijon:

- i. Me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.1999, nëna e subjektit, zonja K. A, së bashku me tre persona të tjerë: Dh.M, O.K dhe N. D, kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., një truall me sipërfaqe 327 m², në G, Kavajë.
- ii. Sipas kësaj kontrate, në këtë truall janë kryer 2,442,200 lekë punime për lokalin në katin e parë, që mbetet në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. Ndërsa, pjesa tjetër e ndërtimit të kësaj ndërtese trikatëshe është blerë sipas preventivit dhe projektit të miratuar, me financim të përbashkët nga katër blerësit në mënyrë të barabartë.
- iii. Me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.8.1999, shoqëria “****” sh.p.k., u ka shitur prindërve të subjektit, F dhe K.A, apartamentin e referuar si më sipër, të ndarë në dy garsoniere, për shumën 3,000,000 lekë.
- iv. Kjo pronë është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kavajë, në emër të nënës së subjektit, znj. K.A, sipas vërtetimit hipotekor me nr. ***, volum ***, 1999-2000.
- v. Sipas aktpjesëtimit vullnetar me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.1999, është bërë pjesëtimi vullnetar i objektit të ndërtuar mbi truallin e blerë nga bashkëpronarët me kontratën e shitblerjes së datës 25.3.1999.
- vi. Sipas këtij pjesëtimi, znj. K.A, i është caktuar si pjesë apartamenti që ndodhet në katin e tretë të kësaj ndërtese, i përbërë nga dy garsoniere, njëra me sipërfaqe 68.5 m² dhe tjetra me sipërfaqe 20 m².
- vii. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, të datës 22.8.2000, kjo pronë i është shitur shtetasit A.I, për shumën 1,100,000 lekë.
- viii. Sipas kontratës së porosisë me nr. ***, datë 27.10.2000, zonja K.A, së bashku me shtetasin N. H (kushëri i babait të subjektit), kanë porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi S. N, pasurinë e llojit “vilë” dykatëshe, të ndodhur në G, Kavajë, më sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore prej 214 m², me vlerë të përgjithshme 25,000 USD (duke u bërë pronarë të kësaj pasurie).
- ix. Subjekti ka shpjeguar se kati i parë i kësaj vile ka qenë në pronësi të nënës së tij. Ndërsa si burim që ka shërbyer për pagesën e ½ pjesë të çmimit të blerjes së kësaj pasurie ka deklaruar se kanë shërbyer kursimet e prindërve të tij ndër vite, si edhe të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve (garsoniereve) që nëna e tij ka pasur në pronësi, shtetasit A.I. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se kjo vilë nuk ka qenë e regjistruar në hipotekë.
- x. Sipas kontratës së huas për blerje banese me nr. ***, datë 11.4.2001, babai i subjektit, F.A, ka marrë hua nga Dega e Bankës së Kursimeve Tirana ***, shumën 2,500,000 lekë, e cila është shlyer përfundimisht në vitet e fundit.
- xi. Me deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 29.7.2002, me deklarues nënën e subjektit, znj. K.A, shtetasit N. H dhe E.H, vila dykatëshe në G (porositur nga shoqëria “****” sh.p.k.) është shkëmbyer po me një vilë dykatëshe (një kat plus papafingo) në fshatin turistik “****” në G, Kavajë, në pronësi të shtetasit E.H. Pra, kjo vilë në bashkëpronësi të shtetasve K.A dhe N.H, me nga ½ pjesë.
- xii. Subjekti ka shpjeguar se është bërë ky veprim juridik, pra shkëmbimi i këtyre dy banesave, për shkakun se në atë kohë vila e fituar në bashkëpronësi sipas kontratës së porosisë (nr. ***, datë 27.10.2000), nuk ishte regjistruar në hipotekë.
- xiii. Në fund të vitit 2004, vila dykatëshe në fshatin turistik “****”, e cila ka qenë në bashkëpronësi të nënës së subjektit dhe shtetasit N.H, me nga ½ pjesë, është blerë përfundimisht nga prindërit e subjektit, për shumën 4,000,000 lekë.
- xiv. Subjekti deklaroi se kjo shumë, e paguar nga prindërit e tij, ka si burim të ardhurat e realizuara nga puna e tyre ndër vite, duke sqaruar se: (i) babai i tij për periudhën 1998 – 2003 ka qenë Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, por edhe në periudhat e mëparshme babai ka pasur rrogë të lartë, pasi ka qenë anëtar i Gjykatës së Lartë dhe deputet i

- Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; (ii) ndërsa nëna e tij ka qenë arsimtare. Gjithashtu, për blerjen e kësaj vile është përdorur edhe kredia e marrë nga babai në ish- Bankën e Kursimeve.
- xv. Sipas subjektit, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë nuk ka pranuar të bënte regjistrimin e kësaj vile sipas dokumentacionit të cituar më sipër (megjithëse ajo faktikisht ishte në bashkëpronësi të prindërve të tij), por ka kërkuar realizimin e këtij veprimi me një kontratë shitjeje. Për këtë shkak, në datën 20.5.2005, është nënshkruar kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. ***, në referim të së cilës shoqëria “***” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi E.H, iu ka shitur subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij vilën dykatëshe me sipërfaqe ndërtimore 93 m², zona kadastrale nr. ***, G, Kavajë, regjistruar me certifikatë pronësie të lëshuar nga ZRPP-ja Kavajë, me nr. ***, datë 14.5.2002.
- xvi. Subjekti ka deklaruar se vlera e shitjes së kësaj pasurie është shënuar shuma prej 40,000 USD, por duke sqaruar se kjo kontratë është bërë për regjistrimin e vilës në hipotekë, pasi kjo vilë ishte blerë nga prindërit e tij përpara se të lidhej kontrata e sipërcituar.
- xvii. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se aktualisht është regjistruar në ZVRPP-në Kavajë vetëm kati i parë i kësaj vile, në bashkëpronësi të subjektit dhe prindërve të tij, pavarësisht se ai nuk ka kontribuar për blerjen e saj. Për sa ka shpjeguar më lart, subjekti figuron bashkëpronar me 1/3 pjesë të pasurisë së llojit “vilë” dykatëshe të ndodhur në G, Kavajë.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

35. Në deklaratën fillestare të pasurisë (dorëzuar në ILDKPKI në muajin mars të vitit 2004), subjekti ka deklaruar se zotëron 2/12 pjesë të pasurisë, vilë dykatëshe, me vlerë 8 milionë lekë, të ndodhur në fshatin turistik G, Kavajë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) nga shitja e një apartamenti në bashkëpronësi në G, Kavajë; dhe (ii) nga kursimet vjetore.

35.1. Në DIP/2004 ka deklaruar se në fund të vitit 2004, ai dhe prindërit e tij, F dhe K.A, i kanë blerë pa dokumente pronësie (pasi kjo pronë nuk është hipotekuar) kushëritit N.H me banim në Durrës, për shumën 4,000,000 lekë, 6/12 pjesë të vilës që kishin në bashkëpronësi me të, në fshatin turistik “***”, G, Kavajë. Deklaron se zotëron 4/12 pjesë takuese të gjithë banesës.

Konkluzionet e ILDKPKI-së për këtë pasuri

- i. Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e prindërve.
- ii. Mungon dokumentacioni i shitjes së ½ pjesë të pasurisë së paluajtshme vilë dykatëshe, në G, në shumën 4,000,000 lekësh, nga shtetasi N.H te prindërit e subjektit.
- iii. Lidhur me shkëmbimin e kryer subjekti ka deklaruar se kontrata e shitblerjes është kryer, pasi është kërkuar nga ZVRPP-ja Kavajë, për arsye se prona nuk ka qenë e regjistruar.
- iv. Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2016, subjekti nuk ka deklaruar kontratën e shitjes nr. ***, datë 19.4.2016, midis ALUIZNI-it dhe blerësve, F, K dhe Altin Abdiu, të trullit me sipërfaqe 489,47 m², ndodhur në G, Kavajë, për vlerën prej 868,830 lekësh.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri

36. ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kavajë⁴⁵ konfirmon se nga verifikimi i bërë në sistemin e pasurive *Albsre-p*, rezulton se në emër subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zona kadastrale ***, e llojit “truall” me sipërfaqe 489.47 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 93 m² (ndërtesë 2 katëshe) dhe se kjo pasuri është krijuar nga bashkimi i pasurisë me nr. ***, volum ***, faqe *** dhe pasurisë me nr. ***, volum ***, faqe ***.

36.1. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit si edhe pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin dhe dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ⁴⁶ për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, rezulton se:

36.1.1. Në datën 25.3.1999, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. K.A, së bashku me tre shtetas të tjerë, Dh.M, O.K dhe N.D, në cilësinë e palës blerëse, nënshkruajnë kontratë shitblerjeje⁴⁷ me shoqërinë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse. Me anë të kësaj kontrate, shoqëria “****” sh.p.k., iu shet shtetasve të sipërcituar pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe prej 327 m², për çmimin prej 10,960 USD, shumë e cila deklarohet se është shlyer tërësisht nga blerësit.

36.1.2. Në vijim, në këtë kontratë referohet fakti se në këtë truall janë kryer 2,442,200 lekë punime ndërtimi sipas situacionit nga vetë shoqëria “****” sh.p.k., për lokal në katin përdhe (parë) që mbetet në pronësi të saj. Ndërsa, pjesa tjetër e ndërtimit të vilës do të bëhej sipas preventivit e projektit të miratuar, financim që përballohet nga blerësi sipas marrëveshjes së përbashkët nga katër financuesit në mënyrë të barabartë.

Gjithashtu, në këtë kontratë pasqyrohet fakti se bashkëfinancuesit kanë rënë dakord për ndarjen e apartamenteve dhe se sipas kësaj ndarjeje të dakordësuar pas ndërtimit të objektit nga shoqëria “****” sh.p.k., znj. K.A (nëna e subjektit) do të përfitojë apartamentet me nr. *** dhe nr. ***, kati i ***, me sipërfaqe 73 m².

36.1.3. Në datën 8.8.1999, shoqëria “****” sh.p.k., iu shet⁴⁸ prindërve të subjektit të rivlerësimit, F.A dhe K.A, pasurinë e llojit “apartament”, të ndodhur në G, për vlerën prej 3,000,000 lekësh, e cila është përcaktuar se do të likuidohej brenda muajit gusht të vitit 1999. Konstatohet se në këtë kontratë nuk janë specifikuar të dhënat për pasurinë objekt transaksioni, madje as sipërfaqja dhe vendndodhja e saktë e saj, si edhe nuk është referuar dokumentacioni mbi bazën e të cilit shitësi provon të drejtat e pronësisë mbi të. Gjithashtu, nuk është përcaktuar nëse kjo kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme lidhet me kontratën e datës 25.3.1999, të nënshkruar mes shoqërisë “****” sh.p.k., dhe znj. K.A.

36.1.4. Referuar vërtetimit nga dokumentet hipotekore, lëshuar nga ZVRPP-ja Kavajë, rezulton se në datën 29.12.1999, është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve, K.A (nëna e subjektit), L.S, Dh.M, O.K dhe N.D, pasuria e llojit “ndërtesë” me sipërfaqe ndërtimi prej 480 m², vilë 3-katëshe me nënçati, ku: (i) kati 1-rë, përbëhet nga lokal e

⁴⁵ Shkresa e ASHK-së, Drejtoria Vendore Kavajë, me nr. *** prot., datë 9.6.2020 (protokolluar në Komision me nr.*** prot., datë 10.6.2020).

⁴⁶ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting” (ndodhur në aneks *** dhe aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së); shkresa e ZVRPP-së Kavajë, me nr. *** prot., datë 20.9.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së; shkresa e Drejtorisë së ALUIZNI-T Tirana *** , me nr *** prot., datë 19.4.2016, administruar në dosjen e ILDKPKI-së; shkresa e ASHK-së, Drejtoria Vendore Zonat e Simuluara, me nr. *** prot., datë 8.6.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.6.2020); shkresa e ASHK-së, Drejtoria Vendore Kavajë, me nr. *** prot., datë 9.6.2020 (protokolluar në Komision me nr.*** prot., datë 10.6.2020).

⁴⁷ Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.1999, redaktuar nga noteri publik, znj. R.S.

⁴⁸ Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.8.1999, redaktuar nga noteri publik, znj. L.Gj.

minimarket dhe një apartament që ndahet në dy garsoniere; (ii) kati i *** dhe i ***, të përbërë nga dy apartamente që ndahen secili në dy garsoniere; dhe (iii) nënçatia përbëhet nga 4 (katër) garsoniere.

36.1.5. Po në datën 29.12.1999, nëpërmjet dokumentit *Akt Pjesëtimi Vullnetar*⁴⁹, bashkëpronarët e pasurisë së sipërcituar dakortësohen për ndarjen e saj. Referuar këtij akti, znj. K.A, merr në pronësi apartamentin që ndodhet në katin e tretë në anën veriore me sipërfaqe totale 68.5 m², i cili përbëhet nga 2 (dy) garsoniere, si edhe 1 (një) garsoniere që ndodhet në katin e nënçatisë, me sipërfaqe 20 m².

36.1.6. Rezulton se bazuar në aktet e mësipërme në emër të shtetases K.A, në regjistrat hipotekorë janë regjistruar 3 (tri) pasuri të llojit “apartament”, me të dhënat si vijon: (i) pasuria me nr. ***, me sipërfaqe 20 m²; (ii) pasuria me nr. ***, me sipërfaqe 38.5 m²; dhe (iii) pasuria me nr. ***, me sipërfaqe 30 m².

36.1.7. Në vijim konstatohet se: (i) në datën 1.8.2000, nëna e subjektit, znj. K. A, i shet⁵⁰ shtetasit I.L apartamentin me sipërfaqe 20 m², për çmimin prej 1,100,000 lekësh; (ii) në datën 22.8.2000, i shet⁵¹ shtetases I. I apartamentin me sipërfaqe 38.5 m², për çmimin prej 1,200,000 lekë; dhe (iii) po në datën 22.8.2000, i shet⁵² shtetasit A.I apartamentin me sipërfaqe 30 m², për çmimin prej 1,100,000 lekë.

36.1.8. Në datën 27.10.2000, zonja K.A dhe shtetasi N.H, (porositësit), kanë lidhur kontratë porosie⁵³ me sipërmarrësin, shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt: ndërtimin e një vile 214 m², në kompleksin e vilave që po ndërtohen në G, të specifikuar me nr. ***, ku përfshihen një dhomë ndenjjeje, dy dhoma gjumi, aneks gatimi, një banjë dhe një verandë, për secilin kat. Gjithashtu, në këtë kontratë përcaktohet se porositësi do të pranojë vilën e porositur dhe do të paguajë për të çmimin 50,000 USD.

36.1.9. Ndërkohë konstatohet se në dokumentin “Aktkolaudimi” për objektin e sipërcituar, është referuar si preventiv vlera prej 4,000,000 lekë, ndërtuar nga firma ndërtuese “****”, financuar nga znj. K.A, shoqëria “****” sh.p.k.

36.1.10. Në datën 29.7.2002, mes shtetasit E.H, si individ, dhe shtetasve N. H dhe K.A, është nënshkruar një deklaratë noteriale⁵⁴, me anë të së cilës palët kanë shprehur dakordësinë për të shkëmbyer ndërtesën dykatëshe të shtetasit E.H ndodhur në një fshat turistik në pronësinë e tij, në Kavajë, me ndërtesën dykatëshe në pronësi të K.A dhe N. H po në Kavajë dhe se kjo deklaratë do të ketë fuqi ligjore deri në përpilimin e kontratës së shkëmbimit.

36.1.11. Komisioni konstaton se nuk janë përcaktuar të dhëna të sakta për pasuritë që do shkëmbehen. Deklarata përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm pa specifikuar saktësisht të dhënat mbi pasuritë objekt shkëmbimi, si edhe pa referuar dokumentacionin mbi bazën e të cilit palët të provonin se gëzonin të drejta reale mbi to.

36.1.12. Në datën 20.5.2005 nënshkruhet kontrata e shitjes⁵⁵ me anë të së cilës shoqëria “****” sh.p.k., iu shet subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij, pasurinë me nr. ***, me sipërfaqe ndërtimore 93 m², ndërtesë dykatëshe, vilë e ndodhur në zonën kadastrale nr.

⁴⁹ Akt pjesëtimi vullnetar me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.1999, redaktuar nga noteri publik, znj. A. N.

⁵⁰ Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2000, redaktuar nga noteri publik, z. S.S.

⁵¹ Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.8.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. A.Sh.

⁵² Kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.8.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. A.Sh.

⁵³ Kontratë porosie me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2000, redaktuar nga noteri publik, z. A. Z.

⁵⁴ Deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 29.7.2002, redaktuar nga noteri publik, znj. A.N.

⁵⁵ Kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2005, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Sh.

***, në G, sipas certifikatës së pronësisë të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me nr. ***, datë 14.4.2002, pronë e regjistruar në volumnin ***, faqe ***, për shumën 40,000 USD, shumë e cila deklarohet se është likuiduar prej blerësve në favor të shitësit, jashtë zyrës noteriale. Në kontratë është përcaktuar se sipërfaqja prej 750 m² e trualli të këtij objekti është marrë me qira për një afat prej 25 vjetësh, me të drejtën e ripërtëritjes, sipas kontratës së lidhur mes shoqërisë ndërtuese dhe Komitetit të Zhvillimit të Turizmit të Republikës së Shqipërisë. Konstatohet se në datën 9.6.2005 ndërtesa është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij, ndërsa rivlerësimi i saj është kryer në datën 28.8.2012, në vlerën prej 18,700,000 lekësh.

36.1.13. Në datën 13.3.2015, z. F.A, në cilësinë e subjektit të interesuar, i drejton kërkesë ALUIZNI-t, për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, në zonën e simuluar të ndodhur në Kavajë, ku ka ndërtuar shoqëria “****” sh.p.k., me të dhënat si vijon: (i) sipërfaqja e bazës së njësisë së ndërtuar 110 m²; (ii) sipërfaqja e përgjithshme e njësisë së ndërtuar 220 m²; (iii) numri i kateve 2 dhe funksioni i njësisë së ndërtuar godinë banimi; (iv) sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë 770 m².

36.1.14. Në datën 12.4.2016, pas njoftimit të dërguar nga ALUIZNI personave të interesuar, subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij, është kryer prej tyre pagesa e çmimit të truallit (me sipërfaqe të përgjithshme 489.47 m² dhe sipërfaqe të bazës së njësisë së ndërtuar prej 93 m²), në shumën 867,830 lekë dhe pagesa e tarifës së përditësimit të pronës në shumën 14,684 lekë.

36.1.15. Në datën 19.4.2016, është lidhur kontrata e shitjes⁵⁶ për kalimin e së drejtës së pronësisë së truallit, në referim të të cilit, ALUIZNI i ka shitur, duke kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij, pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe prej 489,47 m², të ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, të ndodhur në G, Kavajë. Gjithashtu, në këtë kontratë është pasqyruar fakti se blerësi ka paguar vlerën e parcelës ndërtimore në shumën 868,830 lekë dhe tarifën e përditësimit për zonat turistike në shumën 14,984 lekë.

36.1.16. Në datën 6.6.2016, regjistrohet në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij, pasuria e llojit “truall” me sipërfaqe 489,67 m². Në datën 26.7.2016, pas bashkimit të dy pasurive, godinës dykatëshe dhe truallit, është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij, zotërojnë secili 1/3 pjesë takuese të pasurisë së llojit “ndërtesë” dykatëshe me sipërfaqe të bazës ndërtimore prej 93 m², me sipërfaqe totale trualli prej 489.67 m².

36.1.17. Komisioni konstaton se në deklaratën fillestare të pasurisë, babai i subjektit të rivlerësimit, z. F.A, në cilësinë e subjektit deklarues të interesave privatë (depozituar në ILDKPKI në datën 10.3.2004), në seksionin “Pasuri të paluajtshme dhe e drejta reale mbi to” ndër të tjera ka deklaruar se zotëron në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe djalin e tij në total 6/12 pjesë të pasurisë së llojit “vilë” të ndodhur në fshatin turistik G, me sipërfaqe 180 m², me vlerë 8 milionë lekë. Pra, deklaroi se zotëron rreth 17% pjesë takuese të kësaj pasurie.

36.1.18. Gjithashtu, në deklarimin e bërë ka sqaruar se ndërtesa është dykatëshe dhe se njëri nga katet (6/12 pjesë) është në pronësi të shtetasit N.H, banues në Durrës. Ndërsa lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie (pjesës së vilës), ka deklaruar se e ka origjinën tek një apartament që kishin në një pallat në G, që është shitur dhe diferenca nga të ardhurat në vitet 1992 deri 1999.

⁵⁶ Kontratë shitjeje për kalimin e së drejtës së pronësisë së truallit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.4.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. D.P.

36.2. Në DIP/2004, në seksionin “Pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, z. F.A ka deklaruar se: *Në fund të vitit 2004, së bashku me bashkëshorten dhe djalin Altin i kanë blerë kushërrurit të tij, N. H, banues në Durrës, 6/12 pjesë të vilës që kishin në bashkëpronësi, në G, në fshatin “***”, për shumën 4,000,000 lekë. Fshati turistik është i pahipotekuar, prandaj blerja është pa dokumentacion ligjor. Si burim për krijimin e kësaj pasurie ka deklaruar se kanë shërbyer kursimet që kishte dhe ato të vitit të kaluar, duke referuar në fletët e formularëve të depozituar më parë prej tij në ILDKPKI. Gjithashtu ka sqaruar se zotëron 2/12 të pjesës së blerë ose në total 4/12 e banesës (vilës).*

36.3. Në DIP/2005, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë/ pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, z. F.A, ka deklaruar se *banesa në G për të cilën nuk kishte akt pronësie është regjistruar në ZVRPP Kavajë në emër të tij, bashkëshortes dhe djalit Altin, si bashkëpronarë. Ka deklaruar se vlera e kësaj pasurie është 8,000,000 lekë dhe se zotëron 4/12 pjesë të saj.*

36.4. Lidhur me marrëdhënien e shoqërisë “****” sh.p.k., me shtetasit K.A dhe N. H, përfaqësuesi ligjor i saj, z. E.H, ka sqaruar Komisionin se⁵⁷ *në vitin 2005 me cilësinë e administratorit të shoqërisë së mësipërme i ka shitur vilën e sapopërfunduar F, K dhe Altin Abdiu, pagesa për të cilën është bërë pjesë –pjesë jashtë zyrës noteriale. Familja banon në këtë vilë që prej këtij viti. Ndërsa në vitin 2002, kishin rënë dakord për këmbimin e kësaj vile me një banesë tjetër dykatëshe që kishin në bashkëpronësi K.A dhe N.H, gjë e cila nuk u realizua dhe mbeti në pronësi të z. H. Në dijeni e tij banesa në bashkëpronësi nuk ka pasur dokumentacion.*

36.5. Nisur nga faktet dhe rrethanat e parashtruara si më sipër, Komisioni i kërkoi⁵⁸ subjektit shpjegime shtesë mbi marrëdhënien e tij dhe familjarëve të tij me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shoqërinë “****” sh.p.k. dhe/apo përfaqësuesin ligjor të saj, z. E.H.

36.5.1. Në përgjigje të pyetjeve dhe kërkesave të Komisionit, subjekti u ka qëndruar deklarimeve⁵⁹ dhe fakteve të paraqitura më parë se: *i) likuidimi i shumës prej 25,000 USD sipas kontratës së porosisë me “****” sh.p.k është bërë me këste nga nëna e tij, me burim të ardhurat nga shitja e dy garsionereve në pronësi të saj si dhe nga pagat e larta të të atit, për shkak të funksioneve që ka mbajtur; ii) shkëmbimi i banesave dykatëshe në pronësi të palës E.H dhe tjetra në pronësi të K.A dhe N.H, sipas deklaratës noteriale me nr. *** rep., datë 29.07.2002 nuk u realizua; iii) zoti N. H i ka likuiduar cash bashkëpronares K.A shumën 40,000 USD për pjesën takuese që ajo zotëronte në pasurinë e mësipërme, duke u bërë ai pronar i vetëm i pasurisë; iv) këto veprime janë konfirmuar edhe nga zoti N.H përmes një deklarate noteriale; v) kjo shumë është dhënë gjithashtu cash për të paguar “Kontratë shit-blerje pasuri e paluajtshme” Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 20.05.2005 (kontrata e lidhur me shoqërinë “****”) vi) deklaroi se ai si subjekt deklarimi nuk ka kontribuar në blerjen e kësaj shtëpie (i referohet pasurisë objekt vlerësimi, vilës në G) ku figuron si bashkëpronar me 1/3 pjesë; vii) në dijeni e tij shtëpia dy katëshe e përfutur fillimisht nga shtetasit K.A dhe N.H në bazë të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “****”, ka kaluar e gjitha në pronësi të shtetasit N.H, por ende nuk është e regjistruar në hipotekë.*

⁵⁷ Shkresa e shoqërisë “****” sh.p.k., nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i saj, z. E.H, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2022.

⁵⁸ Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 3.

⁵⁹ Referohu përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 (përgjigjet e pyetjes nr. 2), dërguar nga subjekti me e-malin e datës 9.3.2022.

36.5.1.1. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar dokumente provuese⁶⁰.

36.6. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, lidhur me vilën 2-katëshe në G, subjekti ka shpjeguar se⁶¹ sikurse e ka deklaruar edhe në pyetësorin nr. 3, deklarata noteriale nr. *** rep., datë 29.07.2002, midis shtetasit E.H si individ dhe shtetasve N.H dhe K.A nuk u zbatua, sepse bashkëpronarët kërkonin të shtonin sipërfaqen e banimit përtej asaj të porositur dhe të marrë në dorëzim nga shoqëria ***. Pasi kishin filluar problematikat gjatë banimit në këtë banesë, për arsye se ishte një hyrje dhe një kat ishte i tyre dhe një kat i N, në fund të vitit 2004 prindërit e tij diskutuan me shtetasin N.H dhe ranë dakord që të blinin edhe pjesën takuese të tij. Kështu, në fund të vitit 2004 prindërit e tij i kanë paguar shtetasit N.H shumën 4,000,000 lekë për pjesën e tij takuese 6/12 që kishte si bashkëpronar. Për këtë arsye është deklaruar në DPV-në e vitit si nga ana e tij ashtu edhe e babait, që kanë blerë kundrejt çmimit 4,000,000 lekë pjesën takuese të shtetasit N.H. Si burim krijimi për pjesën në shumën 4,000,000 lekë kanë qenë nga kursimet në cash që dispononte babai deri në fund të vitit 2003, si dhe kursimet e krijuara gjatë vitit 2004. Në fillim të vitit 2005 është kërkuar nga shtetasi N.H që të kthente mbrapa veprimin e kryer në fund të vitit 2004, kjo pasi nuk arriti të gjente një banesë tjetër në atë zonë për arsye se ishte me dokumente kosovare, duke i kthyer mbrapsht edhe vlerën prej 4,000,000 lekë të paguar nga prindërit e tij. Gjithashtu, prindërit i shitën këtij shtetasi pjesën e tyre takuese kundrejt çmimit prej 40,000 USD. Me këtë veprim shtetasi N.H kërkoi që të bëhej ai pronar i shtëpisë dykatëshe dhe prindërit e tij të shikonin mundësinë e blerjes së një shtëpie tjetër. Prindërit kanë rënë dakord që të shisnin pjesën e tyre takuese 40,000 USD dhe t'i kthehej edhe shuma e paguar në fund të vitit 2004 prej 4,000,000 lekë. Me shumën e të hollave të arkëtuara nga shtetasi N.H, prindërit kanë blerë shtëpinë tek “***” sh.p.k. Vlera e banesës sikurse është deklaruar nga babai i tij në DPV-në e vitit 2005 ka qenë në shumën 8,000,000 lekë, pavarësisht se në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.05.2005 është vendosur çmimi 40,000 USD, e cila është nënshkruar midis palëve vetëm formalisht për arsye të regjistrimit të pasurisë në ZRPP, pasi nga ana e këtij institucioni nuk është bërë regjistrimi me dokumentacionin që disponohej prej palëve përpara nënshkrimit të kësaj kontrate. Si përfundim, burimi i krijimit për blerjen e banesës në shoqërinë “***” sh.p.k është nga kthimi i shumës 4,000,000 lekë, kursimet e prindërve që dispononin nga pagat e vitit 2005 si dhe të ardhurat nga shitja e pjesës takuese kundrejt çmimit 40,000 Usd.

Në vijim të shpjegimeve të tij ka deklaruar sërish se ai personalisht nuk ka kontribuar financiarisht në blerjen e kësaj banese.

36.7. Sa më sipër, nga analizimi i deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit shkresor të administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ të kryer për pasurinë objekt vlerësimi dhe burimet e deklaruara për krijimin e saj, konstatohet se ka mospërputhje në deklaratat e subjektit lidhur me mënyrën e përfitimit dhe burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi (vilës së ndodhur në fshatin turistik “****”, në G, Kavajë), kjo pasi:

- i. Në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë⁶² rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar me burime: (a) nga shitja e një apartamenti në bashkëpronësi në G Kavajë; dhe (b) kursimet vjetore, duke specifikuar se në vitin 2004 është paguar shuma prej 4,000,000 lekësh në favor të shtetasit N.H, për blerjen e 1/2 pjesë të saj. Ndërkohë, nga hetimi i kryer nuk ka

⁶⁰ Deklaratë noteriale⁶⁰ e shtetasit F.H, datë 8.3.2022, shoqëruar me prokurën e posaçme⁶⁰ datë 28.10.2015, lëshuar nga shtetasi N.H; deklaratë noteriale⁶⁰ e shtetas K.A e datës 9.3.2022.

⁶¹ Dërguar përgjigjet e pyetësorit nr. 4, në rrugë elektronike, me e-malin e datës 15.4.2022.

⁶² Referohu deklaratës fillestare të pasurisë dhe DIP/2004.

- rezultuar që subjekti të ketë pasur në bashkëpronësi pasuri të llojit “apartament” të ndodhur në G, Kavajë.
- ii. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar nëpërmjet shkëmbimit me një pasuri tjetër dhe pagesës së shumës prej 4,000,000 lekësh të bërë në favor të shtetasit N.H, për blerjen e 1/2 pjesë të saj, me burim të ardhurat e prindërve të tij, përfshirë këtu edhe kredinë e marrë nga babai në Bankën e Kursimeve. Ndërkohë, rezultoi e provuar se vlera monetare e përfituar nga kredia e marrë prej babait të subjektit në vitin 2001 (shuma 2,5 milionë lekë), është kaluar plotësisht në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., në funksion të kontratës së porosisë për blerjen e një apartamenti.
 - iii. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3⁶³, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se si burim i blerjes së kësaj pasurie ka shërbyer shuma prej 40,000 USD, të cilën e ka përfituar nëna e tij nga shtetasi N.H, si rezultat i shitjes së pjesës së saj takuese në pasurinë e llojit “vilë” dykatëshe, të porositur/blerë nga shoqëria “****” sh.p.k.
 - iv. Gjithashtu, Komisioni konstaton se nëpërmjet deklaratës noteriale⁶⁴ të datës 9.3.2022, nëna e subjektit, znj. K.A, ndër të tjera ka deklaruar se *nga viti 2000, me kushuririn e bashkëshortit, shtetasin kosovar N. H, kanë blerë një banesë dy katëshe në një fshat turistik pranë “****”, në G. Pas një viti kanë ranë dakord me bashkëpronarin që pjesën e saj takuese (ideale dhe të pandarë) t’ia shiste këtij të fundit kundrejt vlerës 40,000 dollarë amerikanë, pasi arriti marrëveshje për të blerë një një tjetër pasuri në G (tek fshati turistik ****), të cilën e posedon/disponon aktualisht.*

36.8. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4⁶⁵, subjekti ka paraqitur një version tjetër për mënyrën e përfitimit dhe mbi burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi (vilës 2-katëshe, në fshatin turistik “****”, G, Kavajë). Kështu, konstatohet se sipas deklarimeve të dhëna në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti pretendon se fillimisht në vitin 2004, prindërit e tij i kanë blerë shetasit N.H pjesën që ai zotëronte te vila e ndërtuar nga “****” sh.p.k., dhe se në vijim në vitin 2005 prindërve të tij u është kthyer mbrapsht kjo shumë dhe se i është paguar edhe vlera prej 40,000 dollarësh nga shetasi N.H, pasi hoqën dorë nga kjo pasuri. Ka deklaruar se vila 2-katëshe në fshatin turistik “****”, G, Kavajë, është blerë në vitin 2005, në shumën 8,000,000 lekë, me burim nga: (i) kthimi i shumës 4,000,000 lekë; (ii) kursimet e prindërve që dispononin nga pagat e vitit 2005; si dhe (iii) të ardhurat nga shitja e pjesës takuese të vilës së ndërtuar nga “****” sh.p.k., kundrejt çmimit 40,000 USD.

36.9. Ndërsa, në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie e vitit 2005 është bërë me qëllim regjistrimin e vilës në hipotekë, duke pretenduar se nuk ka pasur pagesë të çmimit të përcaktuar në kontratë (shuma prej 40,000 dollarë) në atë vit, pasi kjo vilë ishte blerë nga prindërit e tij përpara se të lidhej kontrata e sipërcituar.

36.10. Sipas aktit të kolaudimit, pjesë e dosjes së vilës së porositur nga nëna e subjektit në datën 27.10.2000, nga shoqëria “****” sh.p.k, rezulton se financues për ndërtimin e kësaj pasurie referohen shtetasja K.A dhe shoqëria e sipërcituar. Pra, shtetasi N.H (i cili figuron të jetë palë porositëse, sipas kontratës së porosisë së datës 27.10.2000), nuk rezulton të jetë financues i këtij objekti, në referim të dokumentit të sipërcituar. Nga ana tjetër, nuk rezulton të ketë dokument për revokimin e kontratës së porosisë të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., si edhe nuk ekziston asnjë dokument shkresor në referim të të cilit shtetasja K.A të ketë hequr dorë nga të drejtat reale të saj mbi këtë pasuri.

⁶³ Dërguar përgjigjet e pyetësorit nr. 3, në rrugë elektronike, me e-malin e datës 9.3.2022.

⁶⁴ Deklarata noteriale me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 9.3.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. E.Q.

⁶⁵ Dërguar përgjigjet e pyetësorit nr. 4, me e-malin e datës 15.4.2022.

36.11. Nisur nga rrethanat e mësipërme, si edhe nga deklaratimet kontradiktore të bëra nga subjekti i rivlerësimit, ngrihen dyshime të arsyeshme se pasuria e llojit "vilë" dykatëshe (pjesa takuese), e ndërtuar në G në funksion të lejes së ndërtimit të nxjerrë për shoqërinë ndërtuese "***" sh.p.k., me financues/investitor shoqërinë "***" sh.p.k., është në disponim dhe/apo posedim të familjarëve të subjektit të rivlerësimit.

36.12. Në DIP/2016, por edhe në deklaratën "Vetting" subjekti nuk ka deklaruar saktësisht si shtesë pasurie pjesën takuese të tij nga blerja e truallit me sipërfaqe prej 489.47 m² (sipas kontratës së shitblerjes së datës 19.4.2016) dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

36.13. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës si dhe iu kërkua të paraqiste argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare, si edhe të depozitonte prova të reja të mundshme mbi konstatimet e mësipërme, në funksion të provueshmërisë së ligjshmërisë së mënyrës së përfitimit dhe burimit të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi.

36.14. Në vijim, vlen të theksohet fakti se pas kërkesës së bërë nga Komisioni në kuadër të verifikimeve të kryera për mënyrën e fitimit dhe kryerjen e pagesave për pasurinë objekt vlerësimi, shitësi E.H nuk ka dhënë detaje për pagesat e kryera nga blerësit, duke mos referuar vlerat dhe periudhat përkatëse të kryerjes së tyre, por duke u mjaftuar me një sqarim të përgjithshëm se: "*Mënyra e pagesës është likuajduar jashtë zyrës noteriale, pjesë - pjesë, duke i përdorur të hollat për ndërtimin e fshatit turistik që ka vazhduar me vite. Kështu ka vepruar për shkak të gjendjes ekonomike*". Pra, sipas deklaratimeve të përfaqësuesit të subjektit shitës, rezulton se ka pasur disa pagesa të kryera nga blerësit në funksion të likuidimit të çmimit të kësaj pasurie deri në vitin 2005, vit në të cilin është nënshkruar kontrata e shitblerjes.

36.15. Në deklaratën "Vetting", por edhe në përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se nuk ka kontribut financiar në shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi (vilës dykatëshe, te fshati "***", G, Kavajë), megjithëse ai paraqitet si palë blerëse në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie. Pra, rezulton se 1/3 pjesë takuese e kësaj pasurie, vlera e paguar për shlyerjen e saj, përbën dhurim në favor të subjektit nga prindërit e tij.

36.16. Si rrjedhim, prindërit e tij do të trajtohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 32/4 të ligjit 84/2016, të cilët kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në këtë rast kryerjen e pagesës së çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

36.17. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, në përmbushje të kërkesave të parashikuara në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale të prindërve të tij, F dhe K. A⁶⁶, të datës 16.5.2022, sipas së cilës ata konfirmojnë dhurimin e bërë, sa i përket pjesës takuese që zotëron djali i tyre, Altin Abdiu, mbi pasurinë objekt vlerësimi.

36.18. Në vijim të hetimeve të kryera, Komisioni verifikoi pasuritë e krijuara (përfshirë edhe ato të tjetërsuara) ndër vite të personave të tjerë të lidhur, prindërve të subjektit të rivlerësimit, si edhe të ardhurat e tyre të provuara me dokumentacion justifikues ligjor⁶⁷.

Gjithashtu, u verifikuan dhe analizuan deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë të bëra nga babai i subjektit në ILDKPKI, në cilësinë e subjektit deklarues.

⁶⁶ Deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. ***, kol., datë 16.5.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. F.Sh.

⁶⁷ Sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe atij të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

36.19. Në referim të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij, në cilësinë e subjekteve deklarues në ILDKPKI, deklarimeve të bëra nga subjekti gjatë hetimit administrativ, dokumentacionin ligjor dhe provave të tjera të administruara në dosje për mënyrën e përfitimit dhe likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, rezulton se: (i) në vitin 2003, prindërit e subjektit kanë paguar 6/12 e vlerës prej 8,000,000 lekë, vlerë e vetëdeklaruar e kësaj pasurie në deklaratat fillestare të pasurisë të vitit 2003; (ii) në vitin 2004, prindërit e subjektit kanë paguar shumën 4,000,000 lekë deklaruar si e dhënë në favor të shtetasit N.H; dhe (iii) në vitin 2005, prindërit e subjektit kanë paguar shumën 40,000 USD, pasqyruar si çmim i blerjes së kësaj pasurie në kontratën përkatëse.

36.20. Komisioni kreu një analizë financiare paraprake me rezervë, me qëllim verifikimin e mundësisë së personave të tjerë të lidhur, prindërve të subjektit, për të përballuar pagesën e plotë të çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, pasuri në të cilën subjekti zotëron 1/3 pjesë takuese, nga ku konstatohet se ata nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht investimet dhe shpenzimet e kryera deri në fund të vitit 2003 (përfshirë dhe pagesën e bërë për pasurinë objekt vlerësimi) balanca negative e fondeve rreth 7.9 milionë lekë, si edhe investimet dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit 2005 (përfshirë dhe pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi), balanca negative e fondeve rreth 3.1 milionë lekë.

36.31. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe të depozitonte prova të reja të mundshme mbi konstatimin e mësipërm, në funksion të provueshmërisë së ligjshmërisë së të ardhave të personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

37. Me anë të prapësimeve të depozituara në Komision si edhe gjatë seancës dëgjimore të datës 24.6.2022, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet/argumentet e tij, si edhe ka depozituar prova të reja shtesë, me qëllim kundërshtimin e rezultateve të hetimit që lidhen me pasurinë objekt vlerësimi (vilës 2-katëshe, të ndodhur në fshatin turistik “***”, G, Kavajë), të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

- i. Së pari, ka parashtruar se kjo pasuri ka vlerën 8,000,000 lekë dhe se ai zotëron 1/3 pjesë takuese të saj, duke sqaruar se *nuk ka asnjë kontribut* në krijimin e kësaj pasurie, pasi ka qenë dëshira e prindërve të tij që të ishte bashkëpronar në këtë pasuri, si djalë i vetëm dhe madhor i familjes. Pra, burimi i pjesës së tij takuese është dhurim nga prindërit.
- ii. Në vijim subjekti ka argumentuar se, pa i hyrë analizës së detajuar financiare, diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve (shpenzimet jetike) të prindërve të tij, deri në vitin 2005 është 14,179,769 lekë. Kjo diferencë është disa herë më e madhe se vlera përkatëse e pasurisë, e cila i është dhuruar nga prindërit dhe si e tillë është një e dhënë financiare bindëse, që duhet ta kishte bindur Komisionin ta kishte kufizuar hetimin vetëm në këtë analizë.
- iii. Në këtë këndvështrim, duke u qëndruar shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorit të fundit të dërguar nga Komisioni se vlera totale e kësaj pasurie është 8 milionë lekë, çmim i paguar nga prindërit e tij në vitin 2005, sa i përket analizës financiare të kryer nga Komisioni, siç u konstatua më sipër, subjekti pretendon se duhej të verifikohet vetëm fakti nëse prindërit e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për kryerjen e pagesës së 1/3 së çmimit, që i përket pjesës së dhuruar në favor të tij dhe jo për të gjithë vlerën e investimit.
- iv. Gjithsesi, subjekti ka parashtruar se për shkak se është kaluar barra e provës, pas konsultimit të bërë me prindërit dhe në referim të akteve që u ka bashkëlidhur

prapësimeve, deklararon se si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi (vilës dykatëshe në G) kanë shërbyer: (i) kthimi i shumës prej 4,000,000 lekësh të paguar shtetasit N.H në vitin 2004; si edhe (ii) të ardhurat nga shitja e pjesës takuese kundrejt çmimit prej 40,000 USD që nëna e tij dispononte tek pasuria e porositur.

37.1. Në përmbledhje të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, në mënyrë kronologjike veprimet dhe transaksionet e kryera nga familjarët e tij për blerjen e kësaj pasurie pasqyrohen si më poshtë:

- i. Sikurse babai i tij ka deklaruar në DPV/2003, familja e tij zotëronte ½ pjesë të një banese dykatëshe në G dhe ½ pjesë i takonte N.H. Në këtë kontekst, subjekti referon nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim verifikimin e faktit se deklaratat e interesave privatë pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI mund të përdoren si provë nga Komisioni.
- ii. Në DPV/2004, gabimisht është referuar nga babai i tij se shuma prej 4,000,000 lekësh i është dhënë shtetasit N.H për banesën e ndërtuar te “***”, ndërkohë që i është dhënë për banesën e ndërtuar nga “***”. Ka argumentuar se kjo ka ndodhur për shkak se deklarata e vitit 2004 është dorëzuar në mars të vitit 2005, periudhë në të cilën shtetasi N.H ua kishte kthyer shumën 4,000,000 lekë dhe se prindërit e tij në këtë kohë kishin paguar paraprakisht (disa muaj para lidhjes së kontratës) shumën e blerjes së banesës në shoqërinë “***”.
- iii. Në fund të vitit 2004, N.H ishte likuiduar dhe nuk kishte pjesë takuese në këtë banesë (i referohet vilës te “***”). Babai i tij ka deklaruar qartësisht burimin që shërbeu për blerjen e pjesës takuese, që ishin kursimet 2,500,000 lekë *cash* të deklaruar nga viti 2003 si edhe kursimet e vitit 2004.
- iv. Në vitin 2005, pasi shtetasi N.H u bind se nuk mund të blinte banesë tjetër (sipas subjektit hasi vështirësi meqënëse ishte shtetas kosovar dhe nuk kishte shtetësi shqiptare) ka kthyer transaksionin e kryer në fund të vitit 2004, duke ridhënë shumën 4,000,000 lekë dhe duke paguar gjithashtu pjesën takuese të familjes së subjektit. Në vitin 2005, prindërit e tij blenë përfundimisht banesën tek “***” dhe prej asaj kohe e disponojnë këtë banesë.
- v. Për arsye se vlera në kontratë është deklaruar 40,000 USD dhe jo në vlerën reale të saj, babai ka dhënë atë shpjegim për të treguar se lidhja e kontratës ka qenë formale, çmimi real i blerjes së kësaj pasurie ka qenë 8,000,000 lekë.

37.1.1. Sa i përket analizës financiare të kryer nga Komisioni, krahas arsytimit dhe argumentimit se ajo duhej të kufizohej vetëm në vlerën e pasurisë së dhuruar në favorin e tij, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ka pretenduar edhe sa vijon:

- i. Vlera prej 4.1 milionë lekësh nuk është paguar nga babai i tij në vitin 2001, në referim të kontratës së sipërmarrjes të nënshkruar me shoqërinë “***” sh.p.k., duke pretenduar se: a) kjo shumë është shënuar në kontratë, pasi ishte kusht nga banka për marrjen e kredisë, b) ky apartament i është shitur një personi tjetër; dhe se (iii) familja e tij ka disponuar dy apartamente te godinat e ndërtuara nga shoqëria “***”, me burim kredinë e marrë në referim të kontratës së sipërmarrjes si edhe shkëmbimin e apartamentit plus shtesës në rrugën “***”.
- ii. Nuk ka pagesë të kryer në vitin 2003 për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, pasi e gjithë shuma është paguar në vitin 2005;
- iii. Në vitin 2005, nënës së tij i është kthyer shuma 4,000,000 lekë nga shtetasi N. H dhe gjithashtu i është bërë pagesa e pjesës takuese që kishte tek vila e “***”, në shumën 40,000 USD.
- iv. Reduktimin e shpenzimeve jetike të përllogaritura nga Komisioni për prindërit e tij.

37.2. Së dyti, subjekti ka deklaruar se përtej tej çdo dyshimi, pasuria e llojit “shtëpi” dykatëshe, e ndërtuar në G në funksion të lejes së ndërtimit të nxjerrë për shoqërinë ndërtuese “***” sh.p.k., me financues/investitor shoqërinë “***”, është në pronësi të shtetasit N.H. Në mbështetje të parashtrimeve të tij, ka depozituar si prova të reja: (i) librezën e ujit të shtetasit N.H, nr. kontrate ***, si edhe disa mandatarkëtime për vitet 2020 dhe 2022; (ii) librezën e energjisë elektrike për kontratën me nr. ***, në emër të shtetasit N.H; (iii) vërtetim të lëshuar nga Njësia Administrative G (nr. *** prot., datë 16.5.20022), me anë të të cilit vërtetohet se z. N.H banon në fshatin G; (iv) deklaratë noteriale⁶⁸ e shtetasit S.Sh, e datës 8.5.2022, referuar nga subjekti si punonjës te kompleksi ku ndodhet vila e ndërtuar nga shoqëria “***” me financues “***”; (v) deklaratë noteriale⁶⁹ e shtetasit Th.M, e datës 9.5.2022, referuar nga subjekti si punonjës në shoqërinë “***”, në fshat turistik të ndërtuar nga një kompani në G.

37.3. Së treti, subjekti ka pranuar se është e vërtetë se në DIP/2016 nuk ka deklaruar saktësisht si shtesë pasurie pjesën takuese nga blerja e truallit me sipërfaqe 489.47 m² dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, por, në deklaratën “Vetting” ka dorëzuar gjithë dokumentacionin e pronësisë për vilën ku përfshihet edhe trualli i saj. Pra, parashtron se kjo është një pasaktësi e karakterit formal, pasi sipas tij, çka është më e rëndësishme, ata (familjarët Abdiu) kanë pasur burime për ta paguar çmimin për blerjen e saj.

Analiza e provave/vlerësimi përfundimtar i Komisionit për këtë pasuri

38. Pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, shqyrtoi parashtrimet dhe shpjegimet e subjektit të paraqitura me shkrim dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, Komisioni vlerëson se:

Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me mënyrën e përfitimit dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, kjo pasi: (i) në vazhdimësi ai ka dhënë deklarime kontradiktore lidhur me periudhën dhe mënyrën e përfitimit të saj; (ii) ka ndryshim të burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie; (a) në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë; (b) në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”; dhe (c) në përgjigjet e dhëna Komisionit gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit.

38.1. Në prapësimet e tij subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo pasuri është përfituar prej prindërve të tij në vitin 2005, duke pretenduar se ka pasur lapsuse në deklaramin e bërë prej tij dhe babait të tij në deklaramin periodike vjetore të vitit 2004, pasi sipas tij, në këtë deklaram kanë dashur të referojnë se i kanë dhënë shtetasit N.H shumën 4,000,000 lekë për pjesën takuese për vilën te “***”, të ndodhur po në G, dhe jo për vilën te fshati “***”. Gjithashtu, ka argumentuar se kjo ka ndodhur për shkak se deklarata e vitit 2004 është dorëzuar në mars të vitit 2005, periudhë në të cilën shtetasi N.H ua kishte kthyer shumën 4,000,000 lekë dhe se prindërit e tij në këtë kohë kishin paguar paraprakisht (disa muaj para lidhjes së kontratës) shumën e blerjes së banesës në shoqërinë “***”.

38.2. Komisioni vëren se nga analizimi i deklarams “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është përfituar nga prindërit e tij nëpërmjet shkëmbimit me një pasuri tjetër dhe pagesës së një vlere në shumën 4,000,000 lekë në favor të shtetasit, N.H, për heqjen dorë prej tij nga kjo pasuri. Si pjesë e dokumentacionit provues mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasuri të depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklarams “Vetting”, paraqitet deklarata noteriale e datës 29.7.2002.

38.3. Gjithashtu, rezulton se vetë nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. K.A, me anë të deklarams noteriale të datës 9.3.2022 (depozituar si provë nga subjektin bashkëlidhur

⁶⁸ Deklaramë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.5.2022, redaktuar nga noteri publik, z. S.S.

⁶⁹ Deklaramë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.5.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. E.Q.

përgjigjeve të pyetësorit nr. 3), ndër të tjera ka deklaruar se nga viti 2000, me kushuririn e bashkëshortit, shtetasin kosovar N. H, kanë blerë një banesë dykatëshe në një fshat turistik pranë “***”, në G. Pas një viti kanë ranë dakord me bashkëpronarin që pjesën e saj takuese (ideale dhe të pandarë) t’ia shes këtij të fundit kundrejt vlerës 40,000 dollarë amerikanë, pasi arriti marrëveshje për të blerë një tjetër pasuri në G (tek fshati turistik “***”), të cilën e posedon/disponon aktualisht.

38.4. Në vijim të trajtimit të këtij pretendimi, Komisioni vëren se në deklaratat periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij, në cilësinë e subjekteve deklarues në ILDKPKI, nuk është deklaruar se kanë zotëruar të drejta reale mbi pasurinë e llojit “vilë” dykatëshe, të përfituar nga marrëdhënie kontraktuale me subjektin “****” sh.p.k., dhe as mbi shkëmbimin, shitjen apo pakësimin e kësaj pasurie. Në të kundërt, nga analizimi në harmoni i deklarimeve të bëra prej tyre ndër vite, trupi gjykues çmon se ata që nga deklarimi fillestar i pasurisë e deri në DIP/2005, vit në të cilin është nënshkruar kontrata e shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi, ka deklaruar se disponojnë pjesë takuese vetëm mbi pasurinë vilë 2-katëshe, të ndodhur të fshati “****”, G, Kavajë.

38.5. Gjithashtu, rezulton se nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë, nga subjekti i rivlerësimit, babai i tij apo nëna si person i lidhur me subjektin deklarues të pasurive, nuk është deklaruar si e ardhur shuma prej 4,000,000 lekësh dhe shuma prej 40,000 USD, të pretenduara nëpërmjet prapësimeve si shuma të dhëna nga shtetasi N.H në fillim të vitit 2005, të referuara si të përdorura për pagesën e vilës të “****”.

38.6. Si konkluzion, bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij ndër vite në ILDKPKI, deklaratës së rivlerësimit kalimtar dhe deklaratës noteriale të datës 29.7.2002, të depozituar bashkëlidhur saj, si edhe deklaratës noteriale të datës 9.3.2022, të znj. K.A, Komisioni krijoji bindjen se pjesët takuese të kësaj pasurie (vilës të “****”, G, Kavajë) janë përfituar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit (familja Abdiu) së paku përpara deklaratimit fillestar të pasurisë (deklaratë e bërë për pasurinë gjendje deri në fund të vitit 2003).

38.7. Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka referuar burime të ndryshme për blerjen e kësaj pasurie, disa nga të cilat provohen se nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e saj. Kështu, në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë⁷⁰ subjekti ka referuar si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat nga shitja e një apartamenti në bashkëpronësi në G, Kavajë. Ndërkohë, nga hetimi i kryer nuk ka rezultuar që subjekti të ketë pasur apartament në bashkëpronësi në G Kavajë. Ndërsa, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se si një nga burimet që ka shërbyer për krijimin e shumës prej 4,000,000 lekësh dhënë në favor të shtetasit N.H për heqjen dorë nga pjesa takuese e tij mbi pasurinë objekt vlerësimi, ka shërbyer kredia e marrë nga babai i tij në vitin 2001. Ndërkohë, rezultoi e provuar se shuma e përfituar nga kjo kredi është transferuar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

38.8. Sa i përket pretendimit të subjektit se analiza financiare e personave të tjerë të lidhur do të duhej të kufizohej vetëm në vlerën e pasurisë së dhuruar në favorin e tij, trupi gjykues vlerëson se kjo pasuri do të trajtohet si një e tërë dhe nuk mund të ndahet vetëm në analizimin e burimeve të përdorura për pagesën e pjesës takuese të subjektit. Në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, personat e tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e dhuruesit kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në këtë rast, vlerësohet se do të duhet të provohet në tërësi ligjshmëria e të ardhurave, të

⁷⁰ Referohu deklaratës fillestare të pasurisë dhe DIP/2004.

cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së llojit vilë 2-katëshe, të ndodhur në G, Kavajë.

38.9. Ky qëndrim i Komisionit përforcohet edhe nga fakti të gjitha pasuritë/të drejtat reale mbi pasuritë të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare të pasurisë, ku përfshihet dhe pasuria objekt vlerësimi, lidhen me transaksione të ndërthurura të subjektit dhe familjarëve të tij, të kryera me mungesë të dokumentacionit të plotë ligjor dhe të deklaruara në mënyrë kontradiktore prej tyre.

38.10. Në kushtet kur, për pasurinë e parë të vlerësuar nga Komisioni, apartamentin në Tiranë, rezulton të ishte e pamundur kryerja e një analize të mirëfilltë financiare, qoftë në kuadrin e analizimit të vlerës së dy pasurive të shkëmbyera, vlerës së pjesës takuese të subjektit në pasurinë në rrugën “****”, e në këtë këndvështrim vlerësimit të kundërvlerës të përkthyer në metra/katrorë që ai duhet të përfitonte prej shkëmbimit, e në vijim të përcaktimit të saktë të vlerës së kompensimit monetar të dhënë në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., duket i tepërt ky pretendim i subjektit dhe vendosja e prindërve të tij si mburojë për përfitimin e çdo pasurie të paluajtshme mbi të cilën ai disponon të drejta reale/pronësie. Pra, duket jashtë logjike arsyetimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit se të ardhurat e realizuara nga prindërit e tij ndër vite janë disa herë më të larta se vlera e pjesës takuese të tij në pasurinë objekt vlerësimi, duke pretenduar të mos përfshihen në analizë pasuritë e tjera të krijuara prej tyre ndër vite.

38.11. Lidhur me mosdeklarimin e saktë të truallit të blerë nga ALUIZNI në vitin 2016, vlerës së tij dhe të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e tij, Komisioni arrin në përfundimin se kjo është një pasaktësi e karakterit formal, për sa kohë subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting” ka depozituar të gjithë dokumentacionin mbi fitimin e bashkëpronësisë mbi truallin në fjalë dhe se nga analiza financiare e kryer rezulton se ka pasur burime financiare të ligjshme për pagesën e çmimit që i përket pjesës takuese të tij.

38.12. Në këtë këndvështrim, Komisioni vlerëson se, në këtë rast, pasaktësia në deklaram është pa pasoja dhe, si e tillë, nuk është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar, duke çmuar se verifikimi i këtyre pasaktësive merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë objekt vlerësimi.

Për sa kohë Komisioni çmon se pasaktësia ose mospërputhja në deklaram është e palidhur me fshehjen e pasurisë, atëherë kjo rrethanë nuk mundet kurrsesi të kualifikohet si një nga rastet e legjitimuara nga Kushtetuta për dhënien e një mase disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

38.13. Lidhur me dyshimet e ngritura se pasuria e llojit vilë dykatëshe (pjesa takuese), e ndërtuar në G në funksion të lejes së ndërtimit të nxjerrë për shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., me financues/investitor shoqërinë “****” sh.p.k., është në disponim dhe/apo posedim të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, në analizë të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se ai nuk arriti që të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se këtë pasuri e posedon, disponon dhe gëzon vetëm shtetasi N.H, kjo për sa kohë nuk kemi deklaram konkret për heqjen dorë nga të drejtat mbi këtë pasuri, nga nëna e subjektit, znj. K.A.

Gjithsesi, Komisioni vëren se kjo është një pasuri që nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, porse hetimi i kryer për të ka pasur lidhje me vërtetimin e provueshmërisë së

deklarimeve të bëra mbi të ardhurat e përfituara prej familjarëve të tij si rezultat i heqjes dorë prej kësaj pasurie, të cilat janë referuar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

38.14. Pas shqyrtimit dhe analizimit të prapësimeve të bëra nga subjekti, në funksion të kundërshtimit të rezultateve të hetimit të dërguara mbi përfundimet e arritura në trajtimin të pagesave kryera, periudhës së kryerjes së tyre, si edhe mbi rezultatet e analizës financiare të personave të tjerë të lidhur, për verifikimin e mundësisë së krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, trupi gjykues argumenton si më poshtë vijon:

38.15. Nisur nga deklaratimet kontradiktore të bëra nga subjekti i rivlerësimit mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, deklaratimeve të bëra mbi vlerën e saj, duke vlerësuar se deklaratat e interesave/privatë të depozituara ndër vite në ILDKPKI kanë fuqi të plotë provuese (kjo edhe në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016), si edhe bazuar në dokumentin shkresor provues, kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, çmohet përfundimisht se: (i) në vitin 2003, prindërit e subjektit kanë paguar 6/12 e vlerës prej 8,000,000 lekësh, vlerë e vetëdeklaruar e kësaj pasurie në deklaratat fillestare të pasurisë të vitit 2003 (ii) në vitin 2004, prindërit e subjektit kanë paguar shumën 4,000,000 lekë deklaruar si e dhënë në favor të shtetasit N.H; dhe (iii) në vitin 2005, prindërit e subjektit kanë paguar shumën 40,000 USD, pasqyruar si çmimi i blerjes së kësaj pasurie në kontratën përkatëse.

38.16. Vlen të theksohet në këtë rast se shitësi i kësaj pasurie, z. E.H, me shkresën e dërguar Komisionit mbi pagesat e kryer nga pala blerësve ka referuar se *mënyra e pagesës është likuiduar jashtë zyrës noteriale, pjesë - pjesë, duke i përdorur të hollat për ndërtimin e fshatit turistik që ka vazhduar me vite. Kështu ka vepruar për shkak të gjendjes ekonomike.* Ndërkohë, nga verifikimi i kryer rezulton se pasuria e blerë nga familjarët Abdiu, vila 2-katëshe në fshatin turistik “****”, G, Kavajë, ka qenë e regjistruar që në vitin 2002 në regjistrat hipotekorë të ZVRPP-së Kavajë. Pra, vlerësimi alternativ i bërë nga Komisioni mbi pagesat e kryera ndër vite për blerjen e kësaj vile dhe vlerës totale të çmimit të paguar, ka ardhur jo vetëm si rezultat i deklaratimeve të bëra në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të pasurive, por edhe i ndikuar nga informacioni i kontradiktor dhe i paqartë i përfutur nga subjekti i rivlerësimit, personat e tjerë të lidhur, prindërit e subjektit dhe nga vetë pala shitëse e kësaj kësaj pasurie.

38.17. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se babai i tij nuk ka kryer pagesën e shumë prej 4,100,000 lekësh në nëntor të vitit 2000, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., është trajtuar në vlerësimin e pasurisë së parë, apartamentit në Tiranë, nga ku Komisioni ka dalë në konkluzionin se kjo pagesë është kryer dhe se ka shërbyer si formë kompensimi për pasuritë e pretenduara si të përfituara me shkëmbim nga subjekti dhe prindërit e tij. Si rrjedhojë, kjo pagesë e kryer do të mbetet si shpenzim në analizën financiare.

38.18. Në referim të vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti, do të shtohet si zë në analizën financiare përfundimtare të personave të tjerë të lidhur, shpenzimi i kryer për ndërtimin e shtesës anësore pa leje prej 44,7 m², pjesë e apartamentit të ndodhur në “****”, Tiranë, në shumën 872,303 lekë.

38.19. Sa u përket parashtrimeve të bëra nga subjekti të rivlerësimit për reduktimin e shpenzimeve jetike të përlllogaritura për prindërit e tij, trupi gjykues e gjen të pavend këtë pretendim, kjo edhe duke konsideruar faktin se në analizën financiare të kryer nga Komisioni është përlllogaritur një vlerë minimale e shpenzuar prej tyre për mobilim/arredim, sipas vetëdeklarimit të subjektit, ndërkohë që personat e tjerë të lidhur dispononin dy pasuri të paluajtshme (nga e cila njëra vilë) dhe se kanë disponuar edhe pasuri të tjera të paluajtshme të cilat i kanë tjetërsuar.

38.20. Komisioni kreu analizën financiare përfundimtare, me qëllim verifikimin e mundësisë së prindërve të subjektit për të përballuar pagesën e plotë të çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, pasuri në të cilën subjekti zotëron 1/3 pjesë takuese, të pasqyruar në mënyrë përmbledhëse në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1.

Analizë financiare - për prindërit e subjektit (Vlerat në lekë)	1992 - 2003	2004	2005
A) Pasuri	21 606 943	1 500 000	5 333 200
Apartament banimi me sipërfaqe 76.7 m ² , në Tiranë	13 520		
Shtesa prej 37.6 m ² në apartamentin e banimit Tiranë	458 386		
Shtesë pa leje 44.7 m ² , në apartamentin e banimit në Tiranë ⁷¹	872,303		
Apartament banimi me sipërfaqe 111 m ² , me adresë: blv. “***”, Tiranë, porositur nga babai i subjektit te shoqëria “***” sh.p.k., sipas kontratës së porosisë ⁷² datë 20.11.2000.	6 600 000		
Truall me sipërfaqe 324 m ² , blerë me kontratën e shitblerjes, datë 25.3.1999, nga shoqëria “***” sh.p.k., për vlerën 10,960 USD. Nëna e subjektit, paguar 1/4 pjesë.	389 984		
Apartament (i ndarë në 3 garsoniere) blerë me kontratën e shitblerjes, datë 8.8.1999, nga shoqëria “***” sh.p.k.	3 000 000		
Vilë dykatëshe me sipërfaqe 214 m ² , në G, Kavajë, porositur nga nëna e subjektit të shoqëria “***” sh.p.k., me kontratën e datës 27.10.2000, me vlerë 50,000 USD. Pjesa takuese 1/2, paguar 25,000 USD.	3 772 750		
Vilë dykatëshe në fshatin “***”, G, Kavajë.	4 000 000	4 000 000	4 133 200
Ndryshim likuiditeti	2 500 000	-2 500 000	1 200 000
B) Detyrime	2 500 000	0	0
Hua nga Banka e Kursimeve	2 500 000		
C) Pasuri neto (A-B)	19 106 943	1 500 000	5 333 200
D) Të ardhura	14 359 265	2 576 665	3 062 128
Të ardhura nga paga F.A (Kuvendi i Shqipërisë).	1 166 415		
	707		
Të ardhura nga paga F.A (Paga kalimtare).	850	534 155	1 026 563
	7 917		
Të ardhura nga paga F.A (Gjykata Kushtetuese).	516	1 874 157	1 857 150
	557		
Të ardhura nga paga K. A.	952		
	609		
Të ardhura nga pensioni K.A.	532	168 353	178 415
Të ardhura nga shitja e apartamentit (3 garsoniere) në G.	3 400 000		

⁷¹ Sipas vetëdeklarimit të bërë nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

⁷² Në referim të kontratës së porosisë, në momentin e nënshkrimit të saj, babai i subjektit ka paguar shumën 4,100,000 lekë. Ndërsa shuma prej 2,500,000 lekësh paguar me transfertë bankare me fondet e disbursuara nga kredia e marrë në Bankën e Kursimeve.

E) Shpenzime	4 036 217	394 902	826 288
Shpenzime jetike	3 466 489	187 728	219 114
Shpenzime për pagesë këste kredie	569 728	207 174	207 174
Shpenzime për mobilim vila 2-katëshe në kompleksin “****”, G, Kavajë ⁷³ .	0		400 000
Balanca e fondeve (D-C-E)	-8 783 895	681 763	-3 097 360

38.21. Sa më sipër, Komisioni konstaton se personat e tjerë të lidhur, prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht investimet dhe shpenzimet e kryera deri në fund të vitit 2003 (përfshirë dhe pagesën e bërë për pasurinë objekt vlerësimi) si edhe investimet dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit 2005 (përfshirë dhe pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi).

38.22. Në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, si edhe personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime të ligjshme për krijimin e saj, duke vënë subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, të ligjit 84/2016.

39. Pasuria e llojit “automjet”, e markës “****”, tip ***, vit prodhimi 2005, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 5.10.2009, me targë AA ***, me vlerë 950,000 lekë.

39.1. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit të markës “****”, tip ***, me targa TR ***, që ka pasur më parë në pronësi, për shumën 900,000 lekë (kontrata e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2009) dhe se si burim fillestar i krijimit të kësaj shume kanë shërbyer kursimet e tij ndër vite.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

39.2. Në DIP/2009, subjekti ka deklaruar se me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2009, ka blerë nga shtetasi J.N, një autoveturë tip “****”, me numër shasie ***, vit prodhimi 2005, në shumën 950,000 lekë. Gjithashtu, ka deklaruar se me kontratë shitjeje mjeti rrugor me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2009, i ka shitur shtetasit M.B, një autoveturë tip “****”, vit prodhimi 2001, me targë TR***, për shumën 900,000 lekë.

39.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjet e DPSHTRR-së.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri

40. DPSHTRR-ja⁷⁴, konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në pronësi të tij mjetin me targë AA*** Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti, Komisioni konstaton se:

- i. në datën 9.9.2009, ky mjet është blerë në Gjermani nga shtetasi J.N, për shumën 11,900 euro (konvertuar me kursin e kohës në shumën rreth 1,575,000 lekë);
- ii. në datën 13.9.2009 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij mjeti dhe janë paguar detyrimet doganore, në total për shumën 529,191 lekë. (vlera statistikore e këtij mjeti/referenca për efekt të pagesës së detyrimeve doganore është përllëgaritur në shumën 1,678,697 lekë);

⁷³ Sipas vetëdeklarimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të Pyetësorit nr. 4, për mobilimin/arredimin e kësaj vile – prindërit e tij kanë shpenzuar në total shumën 1,200,000 lekë, në vitet 2005 – 2008.

⁷⁴ Shkresa me nr. *** prot., datë 8.5.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.5.2020.

- iii. në datën 5.10.2009, shtetasi J.N ia shet⁷⁵ këtë automjet subjektit të rivlerësimit për shumën 950,000 lekë.
- iv. në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, ndër të tjera, është referuar se *palët deklaruan se dorëzimi i mjetit është bërë duke mos pasur blerësi pretendim për gjendjen teknike të tij – gjendje që ai e ka parë në fakt.*
- v. rezulton se ky automjet ka qenë i patarguar në momentin kur është blerë nga subjekti.
- vi. në datën 6.10.2009 janë kryer procedurat e kontrollit fizik të këtij mjete në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë.
- vii. fillimisht ky mjet ka marrë targën AA*** dhe në vitin 2016, pasi më parë ishte deklaruar nga subjekti humbja e targës, ky mjet ka marrë targën AA *** (lëshuar leja e qarkullimit me targat e reja në datën 14.9.2016).

40.1. Pra, referuar të dhënave të mësipërme rezulton se, pa llogaritur shpenzimet e transportit nga vendi i origjinës, pas zhdoganimit të këtij automjeti në datë 13.9.2009, vlera e paguar nga shtetasi J. N ka qenë në shumën rreth 2,100,000 lekë (vlerë blerje plus detyrime doganore). Ndërkohë, rezulton se subjekti e ka blerë këtë pasuri pas rreth 22 ditësh, në shumën 950,000 lekë.

40.2. Nisur nga gjithë të dhënat e mësipërme, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se vlera e shënuar si çmim shitblerjeje në kontratën e datës 5.10.2009 nuk përfaqëson vlerën reale të paguar nga subjekti për blerjen e këtij automjeti. Nga ana tjetër, konfirmohet se në datën 17.9.2009, subjekti i rivlerësimit i ka shitur⁷⁶ shtetasit M.B pasurinë e llojit “automjet” me targë AA***, të markës “****”, tipi ***, vit prodhimi 2001, për shumën 900,000 lekë. Sjellim në vëmendje se të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti janë deklaruar nga subjekti si burim krijim i pasurisë objekt vlerësimi, automjetit me targë AA***.

40.3. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje rezulton se në datën 24.7.2009 subjekti ka depozituar *cash* në “FiBank”⁷⁷ shumën 500,000 lekë, duke e investuar këtë shumë në bono thesari, me afat maturimi 6 muaj. Rezulton se pas maturimit në datën 2.3.2010, kjo shumë është kredituar në llogarinë personale të subjektit në “Raiffeisen Bank” dhe se në vijim është tërhequr plotësisht deri në datën 5.3.2010.

40.4. Komisioni konstaton se në DIP/2009 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investimin e kësaj shume në bono thesari.

40.5. I pyetur nga ILDKPKI-ja⁷⁸ rreth këtij fakti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *meqënëse llogaria ka qenë me një afat të shkurtër 6-mujor, nuk e ka çmuar të domosdoshme për të deklaruar. Gjithashtu dhe fitimi ka qenë shumë i vogël.* Ndërsa, si burim e krijimi të kësaj shumë të investuar ka deklaruar kursimet e tij të deklaruara në deklaratat e interesave privatë ndër vite.

40.6. Për sa kohë në DIP/2009 nuk është deklaruar krijimi i kësaj shumë në sistemin bankar dhe as burimi i krijimit të saj (pretenduar nga subjekti në deklarin e dhënë në ILDKPKI, si e krijuar nëpërmjet pakësimit të likuiditeteve *cash* të deklaruara më parë), Komisioni paraprakisht vlerëson se si burim krijimi i saj mund të kenë shërbyer vetëm të ardhurat e vitit 2009 dhe se në këtë mënyrë do të reflektohet në analizën financiare

⁷⁵ Kontratë shitblerjeje pasuri e luajtshme), me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2009, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Ç.

⁷⁶ Kontratë shitjeje mjete rrugor me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17/9/2009, redaktuar nga noteri publik, znj. F. Sh (ndodhur në aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁷⁷ Shkresa me nr. *** prot., datë 6.5.2020, protokolluar në Komision me nr. ***prot., datë 14.5.2020.

⁷⁸ Procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues”, datë 15.10.2014, përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 3.12.2021.

paraprake të këtij viti. Nga ana tjetër konstatohet se në DIP/2009, subjekti ka deklaruar edhe shtesë likuiditetesh *cash* shumën 200,000 lekë.

40.7. Sa më sipër, Komisioni kreu analizën paraprake e treguesve financiarë për vitin 2009, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka paguar minimalisht rreth 2,100,000 lekë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi (pa përfshirë shpenzimet e transportit nga vendi i origjinës dhe fitimin e mundshëm të shitësit), nga ku konstatohet se ai nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen e automjetit, krijimin e depozitës bankare, shtesën e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të konstatuara nga Komisioni, pasuri të krijuara dhe shpenzime të kryera gjatë vitit 2009, balanca negative e fondeve rreth 1.1 milion lekë.

40.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij dhe të depozitonte prova të reja të mundshme në lidhje me konstatimet e mësipërme, që lidhen me trajtimin e pasurisë objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

41. Në prapësimet e tij subjekti kundërshton çmimin e reflektuar nga Komisioni në analizë financiare si vlerë e blerjes së automjeti në vitin 2009, duke argumentuar se: (i) mjeti ka pasur disa parregullsi teknike; dhe se (ii) shitësi ka qenë në kushte të nevojës emergjente për likuiditete (për arsye mjekësore). Gjithashtu, arsyeton se për sa kohë ka qenë vullneti i palëve, çmimi është ai i përcaktuar në kontratë dhe si i tillë duhet të reflektohet në analizë financiare.

41.1. Në mbështetje të parashtrimeve të tij, ka depozituar si provë të re, deklaratën noteriale⁷⁹ të datës 23.4.2022, të shitësit të kësaj pasurie, shtetasit J. N.

Gjithashtu, lidhur me faktin se çmimi i paguar realisht prej tij për blerjen e pasurisë së llojit automjet në vitin 2009, ka qenë ai i përcaktuar në kontratën e shitblerjes pra 950,000 lekë, dhe jo çmimin prej 2,100,000 lekësh, subjekti ka parashtruar se *bazuar në vendimet e KPA-së 11/2019 dhe 5/2019, vlera e shitjes së sendeve e pasqyruar në akt noterial përbën vlerë të plotë provuese, duke qenë se çmimi është element i kontratës që vendoset nga palët në kontratë. Në këto kushte, në analizën financiare vlera e shitjes së automjetit duhet të shënohet në vlerën e përcaktuar në kontratë.*

Analiza e provave/vlerësimi përfundimtar i Komisionit për këtë pasuri

42. Pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, shqyrtoi parashtrimet dhe shpjegimet e subjektit të paraqitura me shkrim dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, Komisioni vlerëson se:

i) edhe nëse do të merrej i mirëqenë pretendimi i ngritur se shitësi ishte në kushte të nevojës emergjente për likuiditete për arsye shëndetësore⁸⁰, kjo nuk e justifikon shitjen e këtij automjeti me çmim më shumë se dy herë më të ulët nga çmimi i paguar prej shitësit për blerjen dhe zhdoganimin e tij. Vetë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore të çojnë në përfundim të kundërt me sa ai pretendon, pasi ai ka deklaruar se ka pasur njohje me shtetasin J.N, për të cilin referon se ishte shitës makinash. Pra, në një arsyetim logjik, në kushtet kur subjekti kishte njohje me shitësin, nuk është bindëse se ai nuk mund të përfitonte nga kjo situatë, pretenduar si e krijuar për shkak të problemeve shëndetësore të familjarëve të tij; b) nga ana tjetër, duke qenë se sipas subjektit shtetasi J.N ishte shitës makinash, pra një person që në situatë normale ka pasur

⁷⁹ Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.4.2022, redaktuar nga noteri publik, znj. F. Sh.

⁸⁰ Sipas deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe nga shitësi i kësaj pasurie nëpërmjet deklaratës noteriale, të datës 23.4.2022.

kontakte të vazhdueshme me tregtarë automjetesh apo individë të ndryshëm shitës/blerës automjetesh, pra duke e njohur mirë këtë treg, Komisioni vlerëson se edhe në kushtet e një emergjence shëndetësore, në çdo rast ai do kishte aftësinë dhe mundësinë që të shiste këtë automjet të paktën në vlerën e kostos së paguar prej tij. Në këtë kuptim, duket si situatë hipotetike e pamundur shitja prej tij e kësaj pasurie me një çmim që në një vlerësim objektiv është pak më i lartë nga shuma e paguar prej tij për zhdoganimin, transportin dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të mundshme (pa përfshirë këtu çmimin e blerjes prej tij të këtij automjeti, në vlerën prej 11,900 eurosh).

42.1. Gjithashtu, Komisioni vëren se në prapësimet e tij subjekti ka referuar se automjeti ka pasur disa parregullsi teknike. Të njëjtin fakt e ka deklaruar dhe shitësi i kësaj pasurie nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 23.4.2022, duke referuar se *me sa mban mend nga kontrolli që blerësi i bëri automjetit, kishte konstatuar disa defekte teknike*. Por, sikurse u konstatua më sipër, sa i përket këtij aspekti, rezulton se palët janë treguar të kujdesshme, duke referuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie se *dorëzimi i mjetit është bërë duke mos pasur blerësi pretendim për gjendjen teknike të tij, gjendje që ai e ka parë në fakt*.

42.2. Si rrjedhim, Komisioni vëren se përpos deklaratimit kontradiktor të bërë nga subjekti i rivlerësimit, ky fakt tregon edhe një herë se shtetasi J.N, referuar nga vetë subjekti si tregtar automjetesh, duket se është treguar i kujdesshëm duke mos lënë shkas për ngritjen e pretendimeve në të ardhmen nga blerësi i kësaj pasurie (subjekti i rivlerësimit). Në këtë kuptim, nëse gjendja teknike e këtij automjeti do ishte element thelbësor në përcaktimin e çmimit të shitjes, Komisioni vlerëson se palët mund ta kishin referuar këtë fakt në kontratë. Gjithashtu, rezultoi e provuar se kontrolli fizik i këtij automjeti pranë autoritetit përkatës është bërë vetëm një ditë pas blerjes së tij nga subjekti, nga ku rezultoi se nuk u konstatuan parregullsi⁸¹. Në dritën e këtyre fakteve, trupi gjykues çmon se parashikimet e bëra në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie hedhin poshtë pretendimet e subjektit për probleme me gjendjen teknike të mjetit.

42.3. Për sa u arsyetua më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen se në këtë rast vlera e shënuar si çmim në kontratën e shitblerjes së datës 5.10.2009 nuk përfaqëson vlerën reale të paguar nga subjekti për blerjen e këtij automjeti. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon se në kontratën e shitblerjes së këtij automjeti është shënuar një çmim fiktiv, me qëllim për të fshehur vlerën reale të blerjes së tij.

42.4. Si rrjedhojë, Komisioni arrin në konkluzionin se kontrata e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit përmban elementë fiktivë dhe se nuk mund të merret për bazë si dokument, për efekt të analizës financiare që do të kryhet, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit për blerjen e kësaj pasurie.

42.5. Në kushtet kur subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, në analizën financiare të kryer për vitin e blerjes së këtij automjeti, vlera e pasurisë objekt vlerësi do reflektohet në shumën 2,100,000 lekë, që përfaqëson vlerën blerje plus detyrime doganore të paguara nga shitësi, z. J.N.

42.6. Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë për vitin 2009 (vit i blerjes së pasurisë objekt vlerësimi), të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

⁸¹ Shih certifikatën e kontrollit fizik të mjetit nr. serial ***, datë 6.10.2009 (pjesë e dosjes së ardhura nga DPSHTRR-ja për këtë automjet).

Tabela nr. 2.

Analiza financiare për vitin 2009	(Vlerat në lekë)
A) Pasuri	2,799,634
Autoveturë e markës “****”, tip ***, viti i prodhimit 2005.	2,100,000
Ndryshim likuiditeti	699,634
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	2,799,634
D) Të ardhura	1,908,367
Të ardhura nga paga subjekti	990,956
Të ardhura nga shitja e automjetit të tipit “****” *** CDI	900,000
Të ardhura nga interesat bankarë	17,411
E) Shpenzime	225,781
Shpenzime jetike	136,620
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	89,161
Balanca e fondeve (D-C-E)	-1,117,048

42.7. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen e automjetit, krijimin e depozitës bankare, shtesën e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të konstatuara nga Komisioni, pasuri të krijuara dhe shpenzime të kryera gjatë vitit 2009, duke u gjendur edhe në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

42.8. Gjithashtu, Komisioni vëren se në deklaratën “Vetting”, në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë e llojit “likuiditete” si më poshtë vijon:

43. Pasuria e llojit “likuiditete”, depozitë bankare me afat njëvjeçar në “Credins Bank”, në shumën 20,000 euro, shumë e investuar në datën 11.11.2016, sipas kontratës me interes preferencial nr. ***, me interes 0.5 %.

43.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar se shuma e kësaj depozite është krijuar nëpërmjet kursimeve nga paga gjatë viteve të punës deri në vitin 2013.

44. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

- i. Në DIP/2012 subjekti ka deklaruar se kursimet nga paga në vite, shumën 20,000 euro, e ka depozituar të banka “Credins” në datën 9.11.2012.
- ii. Në DIP/2014 ka deklaruar se kursimet nga paga në vite, shumën 20,000 euro, e ka depozituar në “Raiffeisen Bank”, me afat njëvjeçar, me kontratën e datës 24.10.2014.
- iii. Në DIP/2015 ka deklaruar kursime nga paga në vite, shuma prej 22,000 eurosh (nga të cilat 20,000 euro janë depozituar me afat njëvjeçar tek “Credins Bank”, kontrata nr. ***, datë 11.11.2015). Shuma e mësipërme në periudhën 2014 deri 2015 ishte depozituar tek “Raiffeisen Bank”.
- iv. Në DIP/2016 ka deklaruar kursime nga paga në vite, shuma prej 25,000 eurosh (nga të cilat 20,000 euro janë depozituar me afat njëvjeçar tek “Credins Bank”, kontrata nr. ***, datë 11.11.2016). Mbahet *cash* në shtëpi shuma prej 5,000 eurosh.

45. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë 2013 nuk ka deklaruar mbylljen e depozitës në “Credins Bank”, në vlerën 20,000 euro dhe destinacionin e saj.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri

46. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i informacionit/dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ⁸² për llogaritë e subjektit të rivlerësimit, rezultojnë se:

- i. në datën 19.11.2012, subjekti ka depozituar *cash* në “Credins Bank” (në llogarinë në emër të tij, me nr. ***) vlerën prej 20,000 eurosh, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 1-vjeçar;
- ii. siç u konstatua edhe më sipër, në DIP/2012 subjekti ka deklaruar krijimin e kësaj depozite me burim krijimi kursimet nga paga në vite. Gjithashtu, në referim të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetore të depozituara në ILDKPKI, rezultojnë se deri në fund të vitit 2011, subjekti dispononte shumën 2,800,000 lekë, si kursime në formë likuiditetesh *cash*, e krijuar përgjatë viteve 2005, 2006, 2007, 2009, 2010 dhe 2011;
- iii. referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni rezultojnë se vitet 2005 dhe 2009 paraqiten me balancë negative fondesh⁸³ (vite në të cilat konstatohet se subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 600,000 lekë + 200,000 lekë).
- iv. në datën 19.11.2013, depozita 1-vjeçare është maturuar dhe subjekti në datën 9.12.2013 ka tërhequr shumën 647 euro, që përfaqëson interesat e përfituar nga depozita me afat në këtë bankë. Në vijim rezultojnë se në datën 10.12.2013 subjekti ka tërhequr *cash* nga kjo llogari shumën 20,000 euro.
- v. Komisioni konstaton se në DIP/2013 subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e depozitës dhe as destinacionin e shumës 20,000 euro, pas tërheqjes së saj.
- vi. në datën 24.10.2014, subjekti ka depozituar *cash* në “Raiffeisen Bank” (në llogarinë në emër të tij, me nr. ***) në vlerën 20,000 euro, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 1-vjeçar, me përshkrimin “*derdh kursimet nga të ardhurat gjyqtar*”.
- vii. Sikurse u konstatua edhe më sipër, në DIP/2014 subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, kursimet nga paga ndër vite. Por, Komisioni konstatoi se, kursimet nga paga të deklaruara deri në vitin 2011 kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në vitin 2012 në “Credins Bank”, në shumën 20,000 euro. Nga ana tjetër, Komisioni konstatoi se në DIP/2013, subjekti nuk ka deklaruar destinacionin e shumës prej 20,000 eurosh, të tërhequr nga “Credins Bank”. Pra, subjekti nuk ka deklaruar se e dispononte këtë pasuri, qoftë edhe në formë gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit 2013. Në këtë kuptim, konstatohet se si burim për krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” në vitin 2014, mund të kenë shërbyer kursimet e deklaruara në formë likuiditetesh *cash* përgjatë viteve 2012 – 2013, si edhe të ardhurat e vitit 2014, të përfituara deri në datën e krijimit të saj. Komisioni konstatoi se në DIP/2012 subjekti nuk ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash*, ndërsa në DIP/2013 ka deklaruar si kursime *cash* shumën 100,000 lekë. Gjithashtu, rezultojnë se në DIP/2014, subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 500,000 lekë.

⁸² Shkresa e “Credins Bank” me nr. *** prot., datë 17.8.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.08.2020; shkresa e “Raiffeisen Bank” me nr. *** prot., datë 14.05.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.05.2020;

⁸³ Referohu tabelës së analizës përmbljedhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, aneks 1, pjesë e këtij vendimi.

46.1. I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁸⁴, lidhur me mosdeklarimin e pakësimit të depozitës në shumën 20,000 euro në “Credins Bank”, pas tërheqjes së bërë në datën 10.12.2013, si edhe mbi mosdeklarimin e destinacionit të kësaj shume pas tërheqjes, në datën 15.10.2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *në kuptim juridik ai ka deklaruar një depozitë me afat njëvjeçar që nëkupton se ajo do të mbyllet pas një viti nga hapja e saj. Për këtë arsye nuk e ka çmuar të nevojshme se duhej deklaruar mbyllja. Shuma prej 20,000 euro disponohej cash prej tij.*

46.2. I pyetur nga Komisioni⁸⁵ në lidhje me deklaratimet e gjendjes *cash* të disponuara prej tij jashtë sistemit bankar të specifikuar për çdo vit të shprehur në vlerën dhe monedhën e ruajtjes dhe burimin e krijimit të tyre, subjekti ka deklaruar se *në DPV-në e vitit 2012 të gjitha kursimet cash të krijuara deri në fund të vitit 2011 dhe mundësia për kursim gjatë vitit 2012 është depozituar në “Credins Bank” në datën 19.11.2012, në shumën 20,000 euro. Në fund të vitit 2012 nuk ka pasur gjendje cash....Në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar shtesë nga kursimet vjetore nga paga 100,000 lekë. Gjendja cash-it në fund të vitit 2013 ka qënë 100,000 lekë dhe shuma 20,000 euro tërhequr nga “Credins Bank” në datën 10.12.2013. Ky ka qënë veprim i pakësimit të bankës si rezultat i maturimit të depozitës dhe shtimi i cashit pas tërheqjes nga banka. Në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar se shuma prej 20,000 euro me përshkrim kursime nga paga në vite është depozituar në datë 24.12.2014, për një afat një vjeçar”.*

46.3. Komisioni paraprakisht vlerësoi se në kushtet kur rezultoi se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2013, nuk është deklaruar si pasuri gjendje likuiditetesh *cash* shuma prej 20,000 eurosh, e tërhequr nga “Credins Bank”, kjo vlerë duket se nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në shumën 20,000 euro në “Raiffeisen Bank”, krijuar në datën 24.10.2014.

Gjithashtu, për një analizë sa më objektive, Komisioni paraprakisht ka vlerësuar se deri në datën e krijimit të depozitës, subjekti ka shtuar si gjendje *cash* me të ardhurat e vitit 2014, shumën rreth 420,000 lekë dhe jo shumën e plotë prej 500,000 lekësh (deklaruar prej tij si shtesë likuiditetesh *cash* gjatë këtij viti), kjo në qasje të një metode alternative vlerësimi se kjo shumë është krijuar me shtesa kursimesh të përafërta për secilin muaj.

46.4. Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për krijimin në datën 24.10.2014, të pasurisë së llojit “depozitë” në shumën 20,000 euro në “Raiffeisen Bank”, nga ku rezultoi se ai nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e kësaj depozite dhe nga ku rezultoi balanca negative e fondeve në vlerën rreth 2.5 milionë lekë.

46.5. Në datën 6.11.2015, pas maturimit të depozitës në “Raiffeisen Bank”, gjendja e saj prej 20,000 eurosh së bashku me interesat e përfituar, pra në total shuma prej 20,052 eurosh është tërhequr *cash* nga subjekti me përshkrimin “*tërheq për shpenzime familjare*”.

46.6. Në datën 11.11.2015, subjekti ka depozituar *cash* në “Credins Bank” (në llogarinë në emër të tij, me nr. ***) vlerën prej 20,000 eurosh, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 1-vjeçar.

⁸⁴ Procesverballi “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues”, datë 15.10.2014, përcjellë nga ILDKPKI me shkresën nr. *** prot., datë 3.12.2021.

⁸⁵ Referohu pyetësorit nr. 2 dhe përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, dërguar Komisionit me e-mailin e datës 12.11.2021.

46.7. Në datën 11.11.2016, pas maturimit të depozitës dhe përfitimit të interesave kreditorë, subjekti e kaluar shumën fillestare prej 20,000 eurosh në depozitë me afat 1-vjeçar pranë së njëjtës bankë.

46.8. Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, depozitës në shumën 20,000 euro, në “Raiffeisen Bank”, por gjithsesi konstatohet se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin saj, në kushtet kur si burim fillestar për krijimin e saj paraqitet vlera prej 20,000 eurosh, e depozituar prej subjektit në datën 24.10.2014, po në këtë bankë.

46.9. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij dhe të depozitonte prova të reja të mundshme në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

47. Në lidhje me depozitën në vlerën 20,000 euro, subjekti u ka qëndruar sqarimeve dhe shpjegimeve të dhëna më parë në ILDKPKI dhe atyre të dhëna gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni. Subjekti ka parashtruar se ka deklaruar saktë krijimin e kësaj shumë në deklaratat vjetore të dorëzuara pranë ILDKPKI-së dhe se në vijim ka referuar se ka tërhequr *cash* në bankë shumën 20,000 euro në fund të vitit, në datën 10.12.2013, shumë e cila ishte depozituar më parë prej tij në vitin 2012, me burim krijimi nga paga dhe kursimet e tij *cash* ndër vite dhe transaksionet bankare janë transparente e të gjurmueshme.

47.1. Në vijim ka argumentuar se në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, ai ka menduar se nuk ka qenë e nevojshme të deklaronte shumën 20,000 euro si gjendje *cash* në DIP/2013, për sa kohë ai e kishte deklaruar depozitën në vitin 2012 dhe tërheqjen në vitin 2013. Në këto kushte, ka vlerësuar se kishte të bënte vetëm me ndryshim të ndodhjes së parave nga banka në shtëpi.

47.2. Për më tepër, subjekti rithekson se kjo shumë është depozituar sërish prej tij në fund të vitit 2014, për të vetmin fakt, të mosmbajtjes së shumës 20,000 euro në banesë, duke pretenduar se e njëjta shumë, e cila është tërhequr prej tij në bankë në vitin 2013 është depozituar sërish prej tij në të njëjtën llogari në vitin 2014.

47.3. Në mbështetje të prapësimeve, subjekti ka referuar përgjigjet e dhëna prej tij pranë IDKPKI-së sipas procesverbalit të datës 15 tetor 2014, nëpërmjet të cilit ka sqaruar se në kuptimin juridik ka deklaruar (i referohet DIP/2012) një depozite me afat njëvjeçar që nënkupton se ajo do të mbyllet pas një viti nga hapja e saj. Për këtë arsye nuk e ka çmuar të nevojshëm se duhej deklaruar mbyllja. Shuma prej 20,000 eurosh disponohet *cash* prej tij.

47.4. Në përmbyllje të prapësimeve të tij për këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se në deklarimin e kryer prej tij DIP/2014 pranë ILDKPKI-së, ai ka korrigjuar deklaratën e vitit 2013, duke deklaruar se shuma prej 20,000 euro e depozituar prej tij në këtë vit ka qenë “*Kursime nga paga në vite*”.

Arsyetimi ligjor, analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

48. Lidhur me deklarimin e likuiditeteve, referuar nenit 4, pika “d” të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë “*vlerën e likuiditeteve, gjendje cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*”, si edhe burimin e krijimit të tyre.

48.1. Në formularët e deklaramit të pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit” që i përket deklaratës së interesave privatë të vitit 2013, kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) të ndodhura në interesat pasurore privatë të deklaruar më parë, për çdo lloj pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklaramit.

48.2. Për më tepër, Komisioni vëren se ka një diferencë të konsiderueshme kohore midis tërheqjes së këtyre fondeve në dhjetor të vitit 2013 dhe në vijim depozitimit të së njëjtës shumë, në vlerën 20,000 euro, në tetor të vitit 2014. Në vijim të sa më sipër, në dritën edhe të jurisprudencës të Kolegjit, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklaramit të likuiditeteve është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe një pretendim jologjik⁸⁶.

48.3. Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm apo të provonte të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe se analiza ekonomike-financiare në tabelën e paraqitur prej tij, nuk ka vlerë provuese në drejtim të mënyrës së deklaramit dhe përdorimit të likuiditeteve.

48.4. Bazuar në vetëdeklaramimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit, si edhe pas arsytimit të kryer mbi mënyrën e deklaramit të likuiditeteve, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë për periudhën 1.1.2014 – 24.10.2014, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3.

Analiza financiare për depozitën e krijuar në datën 24.10.2014, në “Raiffeisen Bank” (Vlerat në lekë)	Periudha 1.1.2014 – 24.10.2014
A) Pasuri	3 122 200
Ndryshim likuiditeti	3 122 200
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	3 122 200
D) Të ardhura	1 020 896
Të ardhura nga paga subjekti	1 020 896
E) Shpenzime	384 567
Shpenzime jetike	177 204
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	207 363
Balanca e fondeve (D-C-E)	-2 485 871

48.5. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e depozitës në shumën 20,000 euro, në datën 20.10.2014, në “Raiffeisen Bank”.

48.6. Në kushtet kur fondet e depozituara në datën 24.10.2014, në “Raiffeisen Bank”, janë konstatuar si burimi fillestar i krijimit të depozitës në shumën 20,000 euro, në “Credins Bank”, deklaruar si pasuri në deklaratën “Vetting”, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e depozitës

⁸⁶ Referohu trajtimit të bërë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit mbi deklarimin e likuiditeteve, në vendimet: nr. 7/2019 (JR) në pikat 32.4 dhe 32.5, të paragrafit nr 32; nr. 11/2019 (JR), në pikën nr. 27.12.18 të paragrafit nr. 27; nr. 19/2019 (JR), në paragrafin nr. 84; nr. 20/2019 (JR), në paragrafin nr. 59; dhe nr. 29/2019 (JR), në paragrafin nr. 31.

në “Credins Bank”, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit 84/2016.

49. Pasuria e llojit “likuiditete”, gjendje cash, shuma 5,000 euro

49.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kursimet nga paga, duke filluar nga viti 2014 e deri në ditën e deklarimit.

49.2. Deklarimi i likuiditeteve në vite: (i) në DIP/2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime vjetore nga pagat për vitet 2004 - 2005, shumën 600,000 lekë; (ii) në DIP/2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë kursimesh vjetore nga paga, shumën 500,000 lekë; (iii) në DIP/2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë kursimesh vjetore nga paga, shumën 500,000 lekë; (iv) në DIP/2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë kursimesh vjetore nga paga, shumën 200,000 lekë; (v) në DIP/2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë kursimesh vjetore nga paga, shumën 500,000 lekë; (vi) në DIP/2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë kursimesh vjetore nga paga, shumën 500,000 lekë; (vii) në DIP/2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë kursime nga paga ndër vite, shumën 20,000 euro, depozituar në Bankën “Credins” në datën 9.11.2012; (viii) në DIP/2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë kursimesh vjetore nga paga, shumën 100,000 lekë; (ix) në DIP/2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë kursimesh vjetore nga paga për vitin 2014, shumën 500,000 lekë; (x) në DIP/ 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (a) kursime vjetore nga paga për vitin 2015, shumën 500,000 lekë; dhe (b) kursime nga paga në vite, shumën 22,000 euro (nga të cilat 20,000 euro janë depozituar me afat njëvjeçar në “Credins Bank”, kontratë nr. ***, datë 11.11.2015); dhe (xi) në DIP/2016, ka deklaruar: (a) shtesë kursime vjetore nga paga për vitin 2016, shumën 100,000 lekë: dhe (b) kursime nga paga në vite, shumën 25,000 euro (nga të cilat 20,000 euro janë depozituar me afat njëvjeçar në “Credins Bank”, kontrata nr. ***, datë 11.11.2016). Mbahet *cash* në shtëpi shuma 5,000 euro.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri

50. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar saktë ecurinë e pasurive të llojit “likuiditete” ndër vite, pasi, krahas faktit të konstatuar si më sipër se në DIP/2013 subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e pasurisë së llojit “depozitë” dhe as destinacionin e shumës 20,000 euro, pas tërheqjes së saj, në vijim rezulton se nuk ka deklaruar pakësim të likuiditeteve *cash* për vitin 2015. Pra, konstatohet se në vitin 2015 subjekti pretendon se ka si gjendje likuiditetesh *cash* shumën 500,000 lekë me burim krijimi nga të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2015 dhe gjendjen e likuiditeteve (*cash* + bankë) të krijuara nga kursimet në vite në shumën 22,000 euro (nga të cilat 2,000 euro janë gjendje *cash*), ndërkohë, referuar deklarimeve të bëra prej tij, vlera e akumuluar *cash* deri në fund të vitit 2014 ka qenë në shumën 600,000 lekë, ndërsa shuma 20,000 euro ka qenë gjendje në bankë që në vitin 2014.

50.1. Ndërsa, pasi u pyet nga Komisioni lidhur me deklaramet e gjendjes *cash* ndër vite - subjekti ka shpjeguar se⁸⁷ në DPV-në e vitit 2013 ka deklaruar shtesë nga kursimet vjetore nga paga 100,000 lekë. Gjendja e *cash*-it në në fund të vitit 2013 ka qenë 100,000 lekë dhe shuma 20,000 euro tërhequr nga “Credins Bank” në datën 10.12.2013; në DPV-në e vitit 2014, ka deklaruar shtesë nga kursimet vjetore nga paga, 500,000 lekë. Gjendja e *cash*-it në fund të vitit 2014, ka qenë 600,000 lekë; në DPV-në 2015, ka deklaruar shtesë nga kursimet vjetore nga paga, 500,000 lekë. Gjendja e *cash*-it në fund të vitit 2015, ka qenë 1,100,000 lekë (nga të cilat konvertuar në euro janë rreth 2,000 euro); në DPV-në

⁸⁷ Referohu pyetësorit nr. 2 dhe përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, dërguar Komisionit me e-mailin e datës 12.11.2021.

2016, ka deklaruar shtesë nga kursimet vjetore nga paga, 100,000 lekë dhe bashkëjetuesja ka deklaruar kursime cash nga paga në shumën 400,000 lekë. Gjendja e cashit në fund të vitit 2016 ka qenë 500,000 lekë dhe 5,000 euro.

50.2. Sa më sipër, bazuar në vetëklarimet të bëra nga subjekti i rivlerësimit rezulton se pasuria e llojit “likuiditete” në gjendje cash në shumën 5,000 euro, deklaruar në deklaratën “Vetting”, ka si burim të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

50.3. Referuar analizës paraprake financiare të kryer nga Komisioni rezulton se viti 2014 paraqitet me balancë negative fondesh, vit në të cilin konstatohet se subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh cash në shumën 500,000 lekë, të cilat janë referuar dhe si burim krijimi i gjendjes cash në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”. Pas vlerësimit analizimit të prapësimeve të depozituara nga subjekti rezulton se pretendimet e tij mbi analizën financiare të vitit 2014 lidhen me ligjshmërinë e burimeve financiare të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e depozitës 20,000 euro në “Raiffeisen Bank”.

50.4. Në kushtet kur Komisioni në vlerësimin përfundimtar çmoi të mos marrë në konsideratë prapësimet e bëra nga subjekti lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite në vitin 2014, si i vetmi element i cili u kërkua të ndryshohej nga subjekti në analizën financiare të vitit 2014, analiza e treguesve financiarë e kryer nga Komisioni për këtë vit kalendarik nuk ndryshon⁸⁸.

Deklarimi i personit të lidhur, bashkëjetueses, znj. A.D

51. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike”, personi i lidhur ka deklaruar se zotëron shumën 400,000 lekë, me burim kursime nga pagat.

51.1. Gjithashtu, në DIP/2016, në seksionin “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, personi i lidhur (bashkëjetuesja) ka deklaruar shumën 400,000 lekë si pasuri në gjendje likuiditetesh cash.

51.2. Konstatohet se si të ardhura personi i lidhur ka deklaruar: (i) shumën 217,653 lekë, të ardhura nga paga neto prej ditës së fillimit të punës si punonjëse në pozicionin e specialistes në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nga data 5 shtator 2016 deri në 31 dhjetor 2016; dhe (ii) shumën 246,000 lekë të përftuar nga shërbimi i kryer (konsulencë) nga data 17.10.2016 deri në datën 22.12.2016, për fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (Soros), sipas marrëveshjes përkatëse.

51.3. Në referim të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit rezulton se shuma 400,000 lekë, e deklaruar cash nga bashkëjetuesja e tij, ka si burim krijimi kursimet e tij të deklaruara ndër vite.

51.4. Bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se viti 2016, vit në të cilin deklarohet se është krijuar kjo pasuri, paraqitet me balancë pozitive fondesh⁸⁹. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit kanë pasur burime financiare të ligjshme për të krijuar gjatë vitit 2016 pasurinë e llojit “likuiditete cash” në shumën 500,000 lekë, deklaruar si pasuri e cila zotërohet veçmas nga personi i lidhur (bashkëjetuesja e subjektit).

⁸⁸ Referohu tabelës së analizës përmblledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, aneks 1, pjesë e këtij vendimi.

⁸⁹ Referohu tabelës së analizës përmblledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, aneks 1 – pjesë e këtij vendimi.

ÇËSHITJE TË TJERA

52. Automjeti i markës “***”, blerë në vitin 2008, shitur në vitin 2009

52.1. Komisioni konstaton se në DIP/2008 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me kontratë shitjeje *** të datës 26.5.2008, ka blerë nga shtetasi Sh.V, pasurinë e llojit autoveturë, tip “***”, vit prodhimi 2001, me targa gjermane SB***, për vlerën 5,000 euro. Ndërsa, në DIP/2009 ka deklaruar shitjen e këtij automjeti (me targë TR ***), për shumën 900,000 lekë.

52.1.1. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁹⁰, u konfirmua me dokumentacion nga DPSHTRR-ja⁹¹ se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar në pronësi të tij automjetin me targë TR *** .

52.1.2. Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti, Komisioni konstaton se:

- i. në datën 26.5.2008, subjekti ka blerë këtë automjet (targuar SB***) në Gjermani nga shtetasi Sh.V, për shumën 5,000 euro (konvertuar me kursin e kohës në shumën rreth 615,900 lekë);
- ii. në datën 2.6.2008 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti dhe janë paguar detyrimet doganore, në total rreth 448,132 lekë. (vlera statistikore e këtij mjeti/referenca për efekt të pagesës së detyrimeve doganore është përlllogaritur në shumën 951,253 lekë);
- iii. në datën 25.6.2008 janë kryer procedurat e kontrollit fizik të këtij automjeti në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë;
- iv. në datën 27.6.2008 ky mjet ka marrë targën TR *** R;
- v. siç u konstatua edhe më sipër, në datën 17.9.2009, subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë automjet për shumën 900,000 lekë.

52.1.3. Pra, referuar të dhënave të mësipërme rezulton se, pa llogaritur shpenzimet e transportit nga vendi i origjinës dhe të regjistrimit të tij në DRSHTRR-në Tiranë, pas zhdoganimit të këtij automjeti në datën 2.6.2008, vlera e paguar nga subjekti ka qenë në shumën 5,000 euro dhe 448,132 lekë (vlerë blerje + detyrime doganore) në total vlera 1,064,045 lekë.

52.1.4. Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për kryerjen e pagesës së çmimit prej 5,000 eurosh dhe detyrimeve doganore në vlerën 448,132 lekë në vitin 2008, për blerjen e pasurisë së llojit autoveturë të markës “***”, tip “*** CDI”, vit prodhimi 2001, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4.

Analiza financiare e vitit 2008	(Vlerat në lekë)
A) Pasuri	1,063,935
Autoveturë e tipit “***”, viti prodhimit 2001	1,064,045
Ndryshim likuiditeti	-110
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	1,063,935

⁹⁰ Shkresa me nr. *** prot., datë 3.3.2022.

⁹¹ Shkresa me nr. *** prot., datë 16.3.2022, protokolluar në Komision me nr. ***prot., datë 18.3.2022.

D) Të ardhura	1,086,884
Të ardhura nga paga subjekti.	836,884
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës “***”, me targa TR***	250,000
E) SHPENZIME	272,121
Shpenzime jetike	136,620
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	135,501
Balanca e fondeve (D-C-E)	-249,171

52.1.5. Sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e investimit në blerjen e automjetit objekt vlerësimi dhe për të mbuluar kryerjen e shpenzimeve të tjera të konstatuara për vitin 2008, duke rezultuar me balancë negative në vlerën – 249,171 lekë.

52.1.6. Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk ngriti pretendime lidhur analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke e pranuar atë dhe pretenduar se është e vetmja diferencë negative që ai ka ndër vite dhe se bazuar në parimin e proporcionalitetit nuk mund të shërbejë e vetme për marrjen e masës disiplinore.

52.1.7. Sa më sipër, trupi gjykues i qëndron analizës financiare të dërguar me rezultatet e hetimit, duke konfirmuar pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit të markës “***” në vitin 2008 dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera gjatë këtij viti, duke arsyetuar se kjo balancë negative do të vlerësohet në tërësi me gjithë elementet e tjera dhe konstatimet e arritura për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Analiza e të ardhurave nga shitja në vitin 2003, të automjetit “*”**

52.2. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁹² u konfirmua me dokumentacion nga DPSHTRR-ja⁹³ se në pronësi të subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar me targë TR ***. Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti, Komisioni kontaton se: (i) në datën 12.9.2000, subjekti e blen⁹⁴ këtë automjet nga shtetasi K.T, për shumën 200,000 lekë; (ii) në datën 19.6.2003, subjekti i rivlerësimit ia shet këtë automjet shtetasit A.K për shumën 500,000 lekë.

52.3. Komisioni konstaton se në deklaratën fillestare të pasurisë subjekti nuk deklaruar të ardhura nga shitja e këtij automjeti në seksionin “Të ardhura personale nga paga, pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura”, në të cilën deklaroheshin të ardhurat e realizuara/përfituara gjatë vitit 2003.

52.4. Gjithashtu, rezulton se në deklaratën fillestare të pasurisë subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “autoveturë”, me vlerë 500,000 lekë. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja⁹⁵ konstatohet se në datën 22.5.2003, subjekti i rivlerësimit ka blerë në Gjermani automjetin për çmimin 1,900 euro (konvertuar me kursin e këmbimit të kohës në shumën rreth 254,000 lekë). Në datën 28.5.2003 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti dhe janë paguar detyrimet doganore, në total në shumën 184,648 lekë. Pas regjistrimit, ky mjet ka marrë targën TR ***. Gjithsesi, në analizën financiare nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003, si vlerë e blerjes së

⁹² Shkresa me nr. *** prot., datë 3.3.2022.

⁹³ Shkresa me nr. *** prot., datë 16.3.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.3.2022.

⁹⁴ Kontratë shitblerjeje (pasuri e luajtshme), me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.9.2000.

⁹⁵ Shkresa e DPSHTRR-së me nr. *** prot., datë 16.3.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.3.2022.

këtij mjete do të shënohet shuma 500,000 lekë, sipas vetëdeklarimit të bërë nga subjekti, në kushtet kur mund të jenë llogaritur prej tij në përcaktimin e kësaj vlere edhe shpenzimet e transportit dhe/apo të regjistrimit të tij në shtetin shqiptar. Referuar DIP/2008, subjekti deklaroi se e ka shitur këtë automjet për shumën 250,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2008.

52.5. Në vijim të analizimit të transaksioneve të kryera nga subjekti lidhur me automjetin e mësipërme rezultoi se ky automjet është shitur në vitin 2003, rreth 300,000 lekë më shumë se çmimi i paguar nga subjekti për blerjen e tij në vitin 2000, porse nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje nuk rezultoi pagesa e tatimit mbi të ardhurat, për të ardhurat shtesë të realizuara/përfituara nga subjekti nga shitja e kësaj pasurie, në përputhje me përcaktimin e bërë në germën “g”, të paragrafit 1 të nenit 8 të ligjit nr. 9438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

52.6. Në këtë kuptim, Komisioni, në analizën paraprake financiare, për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003, nuk përfshiu të ardhurat shtesë të përfituara nga shitja e kësaj pasurie, pasi nuk vërtetohej shlyerja e detyrimeve përkatëse tatimore për fitimin e rezultuar [çmim shitjeje (çmim blerjeje + shpenzime të tjera)].

52.7. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime dhe prova lidhur me: (i) shitjen e kësaj pasurie me çmim më të lartë nga ai blerjes, duke pasur në konsideratë faktin se automjetet janë pasuri që amortizohen; si edhe (ii) depozitim të dokumentacionit justifikues ligjor për pagesën e tatimit mbi të ardhurat shtesë të përfituara nga shitja.

52.7.1. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, Komisioni vëren se subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me faktin e shitjes së kësaj pasurie me çmim më të lartë nga ai i blerjes. Ndërsa, sa i përket kërkesës për provueshmërinë e pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat shtesë të përfituara nga shitja e kësaj pasurie, subjekti parashtron se: *“Në konkluzionin e tij Komisioni bazohet në përcaktimin e bërë në germën “g”, të paragrafi 1, të nenit 8, të ligjit nr. 9438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar). Në fakt germa “g” është shtuar në paragrafin e parë të nenit 8 të ligjit nr. 9438, datë 28.12.1998, në vitin 2004 sipas ndryshimeve që iu bënë këtij ligji me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998”. Më konkretisht në nenin 2 të ligjit ndryshues parashikohet se: “Në fund të nenit 8, shtohen shkronjat “f” dhe “g” me këtë përmbajtje: (f) të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ia shet një personi tjetër; (g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”.*

52.8. Pas verifikimeve të kryera, Komisioni e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se germa “g” është shtuar në paragrafin e parë të nenit 8 të ligjit nr. 9438, datë 28.12.1998, në vitin 2004, sipas ndryshimeve që iu bë këtij ligji me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003. Por nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk dha shpjegime mbi shitjen e kësaj pasurie me një çmim 2.5 herë më të lartë se çmimi i blerjes pas përdorimit për një periudhë 3-vjeçare, si edhe për shkak se kjo çështje është referuar në rezultatet e hetimit në funksion të qartësisë së metodologjisë së ndjekur për kryerjen e analizës financiare, pasi nuk ndikon në rezultatin e analizës për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003, Komisioni vlerëson të mos e ndryshojë analizën financiare për periudhën në fjalë, të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ.

Analiza financiare për vitet 2003 – 2016

53. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën nga fillimi detyrës deri në datën 31.12.2003, si edhe për çdo vit, për periudhën 2004 – 2016, nga ku rezultoi se vitet 2005, 2008, 2009 dhe 2014 paraqiten me balancë negative të fondeve e konkretisht: (i) për vitin 2005: balanca negative e fondeve (- 45,203 lekë); (ii) për vitin 2008: balanca negative e fondeve (- 249,171 lekë); (iii) për vitin 2009: balanca negative e fondeve (- 1,117,048 lekë); dhe (iv) për vitin 2014: balanca negative e fondeve (- 2,492,458 lekë). Totali i balancës negative në shumën 3,903,880 lekë.

53.1. Pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e analizës financiare, Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të dërguara, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlera e automjetit të blerë në vitin 2009 është ajo përcaktuar në kontratën e shitblerejes dhe se depozita e krijuar në vitin 2014 në “Raiffeisen Bank” ka si burim fondet e tërhequra *cash* në vitin 2013, në “Credins Bank”.

53.2. Këto pretendime janë shqyrtuar nga Komisioni me analizimin dhe vlerësimin e prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit për pasurinë e llojit “automjet” dhe pasurinë e llojit “depozitë bankare”, të referuara si më sipër, të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

53.3. Sa më sipër, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për vitet 2005, 2008, 2009 dhe 2014.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

54. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, për kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Lidhur me pasurinë e llojit “apartment” me sipërfaqe 110 m², të ndodhur në Tiranë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.
- ii. Lidhur me pasurinë e llojit “vilë” 2-katëshe, të ndodhur në G, Kavajë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të saj, si edhe rezultoi se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të shlyer vlerën e plotë të kësaj pasurie, ku përfshihet edhe pagesa e pjesës takuese të subjektit, e deklaruar si e dhuruar në favor të tij.
- iii. Lidhur me automjetin e markës “****”, blerë në maj të vitit 2008, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit për blerjen e tij.
- iv. Lidhur me automjetin e markës “****”, blerë në tetor të vitit 2009, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit për blerjen e tij.
- v. Lidhur me depozitën në shumën 20,000 euro, gjendje në “Credins Bank”, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e saj.

- vi. Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

55. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

55.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin⁹⁶ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Abdiu, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

55.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Abdiu.

55.3. Pas verifikimit të raportit të përditësuar kërkuar pranë DSIK-së nga Komisioni nuk rezulton që nga organet e verifikimit të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, z. Altin Abdiu, në veprimtari të kundërligjshme.

55.4. Në këtë kontekst, DSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit, porse me vendimin e KDZH-së me nr. ***, datë 20.1.2021, ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

55.5. Komisioni kreu hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese.

55.6. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

56. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Abdiu, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

⁹⁶ Raporti me nr. *** prot., datë 2.12.2017.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

57. Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor⁹⁷

57.1 Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

57.2. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

57.3. Të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së: sipas të dhënave nga databaza e ankesave rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtarin Altin Abdiu janë paraqitur gjithsej 5 ankesa (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2014, 2 të vitit 2015, 1 e vitit 2016) në Inspektoratin e ish- KLD-së.

2 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se zgjidhen vetëm përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta (1 ankesë e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2016).

3 ankesat e tjera janë verifikuar dhe kanë rezultuar: (i) 2 ankesa (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2015), nga të cilat ankesa e vitit 2013 e verifikuar për zvarritje gjykimi dhe shkelje etike, është vendosur tërheqje vëmendjeje me shkrim për zvarritje të procesit dhe është vendosur arkivimi për shkelje etike; për ankesën e vitit 2015 për zvarritje gjykimi është vendosur arkivimi, pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtarit; (ii) 1 ankesë tjetër e vitit 2015, e verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është arkivuar pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga gjyqtari.

57.3.1. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Altin Abdiu, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

57.3.2. Në vijim, në raportin e mbajtur nga KLGJ-ja janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

57.4. Nga analiza e të dhënave referuar kriterëve të vlerësimit profesional ka rezultuar se:

Për aftësitë profesionale: ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit ka njohuri të mira të procedurave të gjyqimit të çështjeve gjyqësore penale që ka shqyrtuar;

Për aftësitë organizative: ka aftësi të mira organizative, por nuk i ka kushtuar gjithmonë rëndësinë e duhur gjyqimit dhe arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore. Është konstatuar gjithashtu se 30 nga 56 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, kanë rezultuar të padokumentuara me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale: gjyqtari komunikon me etikë dhe nuk rezulton të ketë përdorur gjuhë diskriminuese me palët në proces; ai ka marrë

⁹⁷ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 3.6.2021.

pjesë në mënyrë të vazhdueshme në trajnimet e Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë programit të saj.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kërkoi subjektit të japi shpjegimet e tij mbi gjetjet e konstatuara në raportin për analizën e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ-ja.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

58. Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësive profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar që lidhet me çështjet objekt ankimi nga subjektet denoncues; dhe (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

58.1. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së (KLGJ-së).

58.2. Në këtë kuadër, Komisioni vlerëson se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi gjetjet e listuara në raportin për analizën e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ-ja, duke depozituar edhe prova të reja në mbështetje të shpjegimeve të tij.

58.3. Si konkluzion, pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënave nga burimet arkivore, si edhe në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit mbi gjetjet e listuara në këtë raport, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me vlerësimin e kriterit profesional.

59. Në vlerësimin e gjyqtarit Abdiu u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 19 (nëntëmbëdhjetë) denoncime të depozituara nga publiku në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

59.1. Nga analizimi i detajuar i denoncimeve të shtetasve A.E⁹⁸, B.K⁹⁹, F.A dhe Sh. A¹⁰⁰, A.B¹⁰¹, N.C¹⁰², M.K¹⁰³, E.N¹⁰⁴, A.A¹⁰⁵, I.S¹⁰⁶, K.K¹⁰⁷, Sh.C¹⁰⁸, nuk u vërejtën fakte apo rrethana, të tilla që, të përbënin prova për gjetje mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Altin Abdiu, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit etiko – profesional.

⁹⁸ Ankesa me nr. *** prot., datë 11.12.2017.

⁹⁹ Ankesa me nr. *** prot., datë 12.2.2018.

¹⁰⁰ Ankesa me nr. *** prot., datë 25.4.2018.

¹⁰¹ Ankesa me nr. *** prot., datë 2.5.2018.

¹⁰² Ankesa me nr. *** prot., datë 25.5.2018.

¹⁰³ Ankesa me nr. *** prot., datë 23.7.2019.

¹⁰⁴ Ankesa me nr. *** prot., datë 31.11.2019.

¹⁰⁵ Ankesa me nr. *** prot., datë 16.10.2020.

¹⁰⁶ Ankesa me nr. *** prot., datë 3.8.2018.

¹⁰⁷ Ankesa me nr. *** prot., datë 30.4.2018.

¹⁰⁸ Ankesa me nr. *** prot., datë 7.10.2019.

59.2. Në vijim, pas shqyrtimit dhe analizimit të denoncimeve të shtetasve B.B¹⁰⁹, R.K¹¹⁰ dhe D.Xh¹¹¹, Komisioni konstaton se pretendimet e denoncuesve kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga ana e gjyqtarit Abdiu dhe në këtë kuptim kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe vendimmarrjen, garant për shqyrtimin e të cilave janë gjykatat e nivelit më të lartë.

59.3. Ndërsa, sa u përket denoncimeve të depozituara nga shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori, znj. E. V dhe ortaku i vetëm, z. D.B¹¹² dhe shtetasi T.Gj¹¹³, trupi gjykues vëren se ato lidhen me çështje të cilat ishin në shqyrtim gjyqësor nga gjyqtari Abdiu dhe në këtë kontekst Komisioni nuk mund t’i trajtojë në tërësinë e tyre pretendimet e denoncuesve, pasi në përputhje me parashikimet e bëra në pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësisë profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

Denoncimi i shtetasës M. H¹¹⁴

60. Denoncuesja ngre pretendime se gjyqtari Altin Abdiu ka treguar mungesë profesionale, arrogancë dhe sjellje të pahijshme në seancë gjyqësore, si edhe ka zvarritur procesin, ndërkohë që çështja ishte e ndjeshme (dhënie pensioni ushqimor), zbardhja e vendimit zgjati 7 muaj, megjithëse sipas saj ishte një vendim i ndërmjetëm.

60.1. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore¹¹⁵ që i përket çështjes civile me paditës: shtetasen M.S (H); të paditur: shtetasin M.S; me objekt: “Zgjidhje Martese”, si dhe pas shqyrtimit të këtij denoncimi, provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka regjistër apo procesverbal ku të dokumentohet data e vendimeve të ndërmjetme të zbardhura. Në këtë kontekst, nuk mund të verifikohen pretendimet e denoncueses, lidhur me vonesa në zbardhjen e vendimit të ndërmjetëm nga ana e gjyqtarit Abdiu.

60.2. Por, nga ana tjetër Komisioni vëren se, referuar informacionit të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet se dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Altin Abdiu, në datën 20.10.2011, pas 37 ditëve nga shpallja, jashtë afatit të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

60.3. Sa më sipër, por nisur edhe nga gjetjet e bëra në raportin për analizimin e aftësive profesionale, trupi gjykues vlen të theksojë se subjekti nuk i ka kushtuar gjithmonë rëndësinë e duhur arsyetimit të shpejtë të vendimeve. Por, gjithsesi, vlerësuar kjo në këndvështrim të ngarkesës së punës, cilësuar sipas raportit mbi standardin minimal, kjo rrethanë nuk mund të ndikojnë si një shkak thelbësor në rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Altin Abdiu.

Denoncimi i shtetasit E.H¹¹⁶

61. Nga verifikimi i kësaj ankese konstatohet se denoncuesi ngre pretendime për veprimet dhe vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, që lidhen me çështjen penale të gjykuar prej tij me të pandehur mjekët: shtetasit E.B., dhe P.R., kallëzuar prej denoncuesit për

¹⁰⁹ Ankesa me nr. *** prot., datë 11.1.2019.

¹¹⁰ Ankesa me nr. *** prot., datë 12.6.2019.

¹¹¹ Ankesa me nr. *** prot., datë 8.7.2021.

¹¹² Ankesa me nr. *** prot., datë 07.3.2022.

¹¹³ Ankesa me nr. *** prot., datë 12.4.2022.

¹¹⁴ Ankesa me nr. *** prot., datë 29.12.2017.

¹¹⁵ Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 28.3.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.3.2022.

¹¹⁶ Ankesa me nr. *** prot., datë 7.2.2018.

kryerjen e veprës penale të “Mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 196 i Kodit Penal.

61.1. Në ankesën e tij denoncuesi parashtron se veprimet dhe vendimi i gjyqtarit Altin Abdiu në gjykimin e kësaj çështjeje tregojnë nivel të ulët profesional, duke hedhur dyshime se përmbajnë brenda tyre elemente të korrupsionit. Referuar denoncuesit, në konkluzionet përfundimtare prokurori i çështjes ka kërkuar 5 (pesë) vite burg dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit të mjekut për pesë vjet pas vuajtjes së dënimit, për secilin nga të pandehurit. Në kundërshtim me sa kërkoi prokurori, gjyqtari Altin Abdiu shpalli vendimin, duke deklaruar fajtor të pandehurit E.B., dhe P.R., për veprën penale të “Mjekimit të pakujdesshëm” dhe dënimin e tyre me nga 400,000 (katërqind mijë) lekë secili. Këtë vendim të gjykatës, në cilësinë e palës së dëmtuar, e quan haptazi të padrejtë dhe të turpshëm.

61.2. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore¹¹⁷ që i përket çështjes penale me të pandehur shtetasit E.B dhe P.R, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mjekimi i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal, konstatohet se: i) pas hetimeve të kryera, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dërguar për gjykim çështjen në ngarkim të shtetasve E.B dhe P.R dhe si përfundim ka kërkuar: (1) Deklarimin fajtor të së pandehurës E. B për kryerjen e veprës penale “Mjekim i pakujdesshëm”, bazuar në nenin 96 të Kodit Penal, dënimin e saj me 5 vjet burgim. Në zbatim të nenit 30 dhe 39 të Kodit Penal, të pandehurës t’i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit të mjekut dhe e çdo veprimtarie që ka lidhje me këtë profesion, për një periudhë 5-vjeçare; (2) Deklarimin fajtor të të pandehurit P.R për kryerjen e veprës penale “Mjekim i pakujdesshëm”, bazuar në nenin 96 të Kodit Penal, dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në zbatim të nenit 30 dhe 39 të Kodit Penal, të pandehurit t’i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit të mjekut dhe e çdo veprimtarie që ka lidhje me këtë profesion, për një periudhë 5-vjeçare; ii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përbërje të trupit gjykues të së cilës si anëtar i vetëm paraqitet subjekti i rivlerësimit, në datën 21.6.2016, ka vendosur: (1) Deklarimin fajtor të së pandehurës E.B për kryerjen e veprës penale “Mjekim i pakujdesshëm”, bazuar në nenin 96 të Kodit Penal, dënimin e saj me 400,000 lekë gjobë; (2) Deklarimin fajtor të të pandehurit P.R për kryerjen e veprës penale “Mjekim i pakujdesshëm”, bazuar në nenin 96 të Kodit Penal, dënimin e tij me 400,000 lekë gjobë; iii) referuar informacionit të dërguar nga Gjykata e Apelit rezulton se kjo dosje aktualisht ndodhet në këtë gjykatë, porse ende nuk është planifikuar për gjykim.

61.3. Pasi Komisioni u vu në dijeni se ish-Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë kishte vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Altin Abdiu pas ankesës së bërë nga shtetasi E. H, që lidhet me çështjen objekt denoncimi, i kërkoi¹¹⁸ Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacion mi ecurinë dhe përfundimet e këtij hetimi disiplinor. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informon se¹¹⁹ ankesa e z. E. H ndodhet në fazën e shqyrtimit fillestar. Ndërkohë, nga verifikimi i praktikës së mbajtur lidhur me këtë ankesë, rezulton se me vendimin nr. *** prot., datë 29.8.2017, ish-Inspektorati i KLD-së ka vendosur pezullimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Altin Abdiu, që lidhet me çështjen objekt denoncimi, me arsyetimin se duhet të pritet vendimmarrja e gjykatave

¹¹⁷ Dërguar dosja nga Gjykata e Apelit Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 11.4.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.4.2022. Gjithashu, me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2022 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.4.2022), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dërguar kopje të njësuar me origjinalin të vendimit nr. *** , datë 21.12.2016, të kësaj gjykatë, që lidhet me çështjen objekt ankimi.

¹¹⁸ Shkresa e Komisionionit me nr. ***prot., datë 1.4.2022.

¹¹⁹ Shkresa e ILD-së me nr. *** prot., datë 21.4.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.4.2022.

më të larta, pasi pretendimi objekt hetimi disiplinor lidhet me vendimmarrjen e gjykatës dhe si e tillë, në arritjen e një konkluzioni të saktë në këtë hetim administrativ luan edhe kontrolli gjyqësor.

61.4. Sa më sipër, pa dashur t'i hyjë themelit të çështjes, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegimet e tij shteruese dhe të argumentonte mbi arsyet dhe kriteret në të cilat u bazua për të përcaktuar llojin dhe masën e dënimit ndaj të pandehurve të kësaj çështjeje penale, si edhe për mosaplikimin e dënimit plotësues ndaj tyre, krahas atyre të dhëna në arsyetimin e vendimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këtë denoncim

62. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, gjetjet dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në këtë rast ka vlerësuar se masa e aplikuar ndaj të pandehurve është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore të nenit 47 të Kodit Penal, në të cilin përcaktohet se: *“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*.

62.1. Në vijim ka parashtruar se për të caktuar llojin dhe masën e dënimit ka vlerësuar: (i) nënyrën se si është kryer nga ana objektive vepra penale nga të pandehurit, duke argumentuar se pavarësisht se ka deklaruar fajtor të pandehurit, në llojin dhe masën e dënimit është bazuar në konkluzionin e arritur në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, se: *“Shkaku i drejtpërdrejtë dhe shkencor i vdekjes së shtetas D.H., nuk mund të përcaktohet”*. Pra, pavarësisht se nga provat janë konstatuar disa veprime të pakujdesshme gjatë trajtimit mjekësor të pacientes, D.H., shkaku i vdekjes nuk është përcaktuar dhe në këto kushte, ka vlerësuar edhe parimin e rëndësishëm penal se *“Çdo dyshim çmohet në favor të të pandehurit”*; (ii) faktin që kjo vepër penale nga ana subjektive është kryer në formë faji pakujdesi, e cila tregon një shkallë relativisht të ulët të rrezikshmërisë të autorit. Gjithashtu, subjekti ka arsyetuar se dënimi plotësues nuk është detyrues, por fakultativ në varësi të rrethanave të çështjes, duke referuar nenin 39 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se: *“Heqja e të drejtës së ushtrimit të një veprimtarie jepet për një kohë nga një muaj deri në 5 vjet dhe është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra penale që kryhen duke i shpërdoruar ato, ose ku vlerësohet se ushtrimi i mëtejshëm i veprimtarisë apo profesionit bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale konkrete”*.

62.2. Në këtë kontekst, subjekti parashtron se vepra penale konkrete nuk është kryer duke shpërdoruar detyrën, pasi nëse përdoret fjala “shpërdorim” nënkuptohet një veprim të kryer me dashje, por siç u theksua më sipër, sipas tij, në rastin konkret vepra penale nga të pandehurit është kryer me pakujdesi.

62.3. Si përfundim, subjekti deklaroi se nuk ka vlerësuar se ushtrimi i mëtejshëm i profesionit të mjekut nga të pandehurit bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale konkrete, pasi veprimtaria e mjekut mbron jetën dhe shëndetin e shtetasve, dhe si e tillë, jo vetëm nuk bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale, por e mbron këtë marrëdhënie.

Vlerësimi i Komisionit për këtë denoncim

63. Nga shqyrtimi në tërësi i kësaj ankese, dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ lidhur me çështjen objekt denoncimi, në proporcionalitet me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, i cili duket se arsyetoi në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse se ka vendosur jo

vetëm sipas bindjes së tij të brendshme, por edhe provave të administruara, Komisioni konstaton se në dukje pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga ana e gjyqtarit Abdiu dhe në këtë kuptim kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe vendimmarrjen, garant për shqyrtimin e të cilave janë gjykatat e nivelit më të lartë.

Denoncim i shtetas M.B¹²⁰

64. Nga verifikimi i kësaj ankese Komisioni konstaton se denoncuesja ngre pretendime për vendimin e datës 3.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga gjyqtari i vetëm Altin Abdiu, vendim i cili lidhet me kërkesën e saj për shuarjen e masës së sigurimit personal me karakter ndalues, të *“Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”*, parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale. Denoncuesja parashtrohet se ky vendim është marrë në mungesë të prokurorit, pasi megjithëse ai kishte marrë njoftim, nuk ishte prezent. Kështu, sipas saj, pa dijeninë e prokurorit, ky gjyqtar ka kërkuar përsëritjen e masës së sigurimit personal me karakter ndalues, ndaj personit nën hetim, M.B, *“Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”*, parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale, për një afat 1-vjeçar. Denoncuesja lë të kuptohet se ky vendim është marrë si hakmarrje e kryer nga persona të tjerë, pjesë e sistemit gjyqësor, mbi faktet e denoncuar në vazhdimësi prej saj, që lidhen me çështjen e vrasjes së bashkëshortit të saj, shtetasit A.B.

64.1. Pasi kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim, personi nën hetim, M.B, në datën 16.6.2020, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur:¹²¹ *“Prishjen e vendimit nr. *** Regj.Them, datë 3.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë”*.

Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit Tiranë, pasi ka parashtruar të njëjtat argumente të dhëna nga organi i akuzës, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në vendimmarrjen e saj, pasi ka lejuar zhvillimin e seancës gjyqësore pa praninë e prokurorit, në kundërshtim me nenin 244, pika 1 të K.Pr.Penale, ku parashikon qartë se masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Në vijim të arsyetimit të saj, Gjykata e Apelit Tiranë ka argumentuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimmarrjen e saj nuk ka respektuar dispozitat procedurale lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, pasi në rastin konkret ajo duhet të kishte shtyrë seancën deri në paraqitjen e prokurorit, i cili është organi i vetëm që vë në lëvizje gjykatën në caktimin e masave të sigurimit. Në kushtet kur kjo shkelje, në kuptim të nenit 128/a të K.Pr.Penale, sjell pavlefshmëri absolute të vendimit objekt ankimi, Gjykata e Apelit Tiranë, konform nenit 428/1 të K.Pr.Penale, ka vendosur të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të kthejë çështjen për rigjykim në atë gjykatë.

64.2. Pra, konstatohet se në gjykimin e kësaj çështje, gjyqtari Abdiu nuk ka respektuar dispozitat procedurale që lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, duke sjellë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit bazuar në nenin 128/a, paragrafi 1, germa “b” të K.Pr.Penale, dhe si rrjedhojë disponimin nga Gjykata e Apelit Tiranë për prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, në përputhje me nenin 428/1/ç të K.Pr.Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këtë denoncim

65. Pasi Komisioni i kërkoi shpjegime lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe gjetjet e bëra në trajtimin e tij, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit,

¹²⁰ Ankesa me nr. *** prot., datë 3.8.2020.

¹²¹ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, me nr. ***, datë 16.6.2020.

subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se kjo çështje është jashtë periudhës së rivlerësimit dhe se gjithashtu ankesa e znj. M. B, është marrë në shqyrtim nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili me vendimin nr. ***, datë 28.3.2021, ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, për shkak se shkelja e konstatuar nga Gjykata e Apelit vlerësohet se nuk është e natyrës që përbën shkelje disiplinore, sipas përcaktimeve të nenit 102/2, shkronja “a” të të njëjtit ligj¹²².

Vlerësimi i Komisionit për këtë denoncim

66. Në vlerësim përfundimtar të konstatimit të bërë nga Komisioni pas shqyrtimit të këtij denoncimi, në raport me shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se qëndron konstatimi fillestar i dërguar me rezultatet e hetimit, por se gjithsesi ky rast i vlerësuar si një rast i shkëputur dhe jo si një qasje e vazhdueshme e subjektit të rivlerësimit, nuk mund të ndikojë si një shkak thelbësor në rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Altin Abdiu.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

67. Si përfundim, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të përsëritura e të qenësishme të natyrës procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

IV. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- i. subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. subjekti arrin nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

¹²² Ka depozituar si provë bashkëlidhur prapësimeve të tij, vendimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. *** prot., datë 28.7.2021 (pjesë e dokumentacionit të dërguar subjektit nga ILD, me shkresën “kthim përgjigje” me nr. *** prot., datë 18.5.2022.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Altin Abdiu, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 28.6.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Pamela QIRKO
Relatore

Suela Zhegu
Anëtare

Amela Idrizi
Sekretare gjyqësore

ANEKS 1 - TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

Analiza e treguesve financiarë për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datë 31.12.2003 dhe për vitet 2004-2016	Nga fillimi i detyrës - deri 31.12.2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	500,000	0	638,889	507,247	454,340	1,063,935	2,799,634	108	510,303	-15,215	-2,414,494	3,301,809	451,192	323,410
Apartament banimi me sipërfaqe 110 m2, pallati "****".											280,000			
Vilë dy katëshe në ***, Kavajë.														294,605
Autoveturë e markës ***, viti prodhimit 1993, me targa ***.	500,000													
Autoveturë e markës ***, viti prodhimit 2001 me targa ***.						1,064,045								
Autoveturë e markës ***, viti prodhimit 2005 me targa ***.							2,100,000							
Ndryshim likuiditeti	0	0	638,889	507,247	454,340	-110	699,634	108	510,303	-15,215	-2,694,494	3,301,809	451,192	28,805
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C) PASURI NETO (A-B)	500,000	0	638,889	507,247	454,340	1,063,935	2,799,634	108	510,303	-15,215	-2,414,494	3,301,809	451,192	323,410
D) TË ARDHURA	3,164,743	760,361	774,316	807,344	791,915	1,086,884	1,908,367	1,046,705	1,157,023	1,067,474	1,111,747	1,236,712	1,273,638	1,758,960
Të ardhura nga paga subjekti.	2,964,743	760,361	774,316	807,344	791,915	836,884	990,956	1,046,705	1,157,023	1,067,474	1,021,031	1,236,712	1,266,480	1,273,771
Të ardhura nga puna personi i lidhur.														464,493
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës *** me targa ***.	200,000													
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës *** me targa ***.						250,000								
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës *** me targa ***.							900,000							
Të ardhura nga interesat bankare							17,411				90,716		7,158	20,696
E) SHPENZIME	1,384,312	456,538	180,630	109,557	229,116	272,121	225,781	362,880	211,994	333,838	394,103	427,361	418,363	698,114
Shpenzime jetike	1,034,312	93,864	109,557	109,557	136,620	136,620	136,620	136,620	136,620	141,024	141,024	219,998	224,276	470,184
Shpenzime për mobilim	350,000	350,000												
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	0	12,674	71,073	0	92,496	135,501	89,161	226,260	75,374	192,814	253,079	207,363	194,087	227,930
Balancë e fondeve (D-C-E)	1,280,431	303,823	-45,203	190,540	108,459	-249,171	-1,117,048	683,717	434,727	748,851	3,132,138	-2,492,458	404,083	737,437

